

E PËRDITSHME
E PAVARURDrejtör:
FAHRI BALLIU
Kryeredaktor:
ILIR NIKOLLANr. 304 (5094)
Viti XVI i botimit
(numri i parë doli
më 18.10.1997)E shtunë,
3 nëntor 2012

55

Adresa: Rruga
"Medar Shtylla",
qendra e biznesitTel: 04/2321364,
Tel: 04/2321366,
Fax: 04/2321365,
TiranëE-mail:
info@gazeta55.net,
gazeta55mail@
yahoo.com,Internet:
www.gazeta55.al
Çmimi 30 lekë
Greqi 1,5 EURO

BOTIMI I RI

"Sigurimi i Shtetit 1944 – 1991. Historia e policisë politike të regjimit komunist"
Shtëpia Botuese "55" sapo ka hedhur në treg librin e ri të autorit Kastriot Dervishi, studimi i parë i plotë në lidhje me aktivitetin e një prej strukturave më të mprehta të diktaturës komuniste në Shqipëri.



Berisha, apel opozitës të votojë reformat, për të mos dëmtuar integrimin

► Shefi i Ekzekutivit i bën thirrje opozitës parlamentare t'i përgjigjet apelit të aleatit të madh të shqiptarëve, sekretares Klinton, dhe të votojë 3 ligjet e bllokuara në parlament, të cilat po mbajnë peng formalizimin e vendimit për marrjen e statusit kandidat për në BE

► **Deklarata e Berishës:**
"Zgjedhjet e ardhshme do të jenë të lira dhe demokratike"

DITA

EURALIUS dhe Ministria e Drejtësisë, reformë për modernizimin e administratës gjyqësore

► Presidenti Bujar Nishani nis të hënën konsultat me partitë politike për datën e zgjedhjeve
Axhenda, takime të veçanta me krerët e grupeve parlamentare

DITA

100 vjetori i Pavarësisë, Kryeministri Berisha viziton ekspozitën me dokumente nga Lidhja e Prizrenit deri në Kongresin e Lushnjës
Berisha: Shqiptarët, përpjekje politike dhe diplomatike për ndërtimin e një shteti funksional



Kuvendi nderon

22 gra të shquara

Kuvendi i Shqipërisë nderoi dje kontributin dhe dinjitetin e grave të shquara shqiptare, në 100 Vjetorin e Pavarësisë.

DITA/3

Edhe pas 48 orësh, PS s'e ka kuptuar ende mesazhin e Klintonit

Njëri nga të përdorurit e kohëve të fundit të Edi Ramës, doli dje dhe ribëri një variacion mbi temën e kushtëzimit të ligjeve të statusit me gllabërimin e Qarkut të Fierit. Deklaratat e Majkos mund të konsiderohen si gjysmë-zyrtare, sa kohë publiku ka marrë vesh se edhe pas 48 orësh, kryetari i PS-së ende s'e ka kuptuar mesazhin e Hillari Klintonit



FORUM

DOSSIER/INTERNIMET E VITIT 1954

"Internim për simpati ndaj regjimeve të kaluara"
Qiramarrësit në gjyq, si cjapi te kasapi!

Nga Kostaq Xoxa

Proza e autorëve françeskanë mes dy luftërave botërore

Nga Kastriot Marku

100 vjetori i Pavarësisë, Kryeministri Berisha viziton ekspozitën me dokumente nga Lidhja e Prizrenit deri në Kongresin e Lushnjës

Berisha: Shqiptarët, përpjekje politike dhe diplomatike për ndërtimin e një shteti funksional

Kryeministri Sali Berisha mori pjesë dje në çeljen e ekspozitës dokumentare "Koha e Memorandumeve nga Lidhja e Prizrenit deri në Kongresin e Lushnjës". Ekspozita, e cila u hap në mjediset e Bibliotekës Kombëtare në kuadër të festimeve me rastin e 100 vjetorit të Pavarësisë, paraqet një përzgjedhje nga fondi i Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë, të Memorandumeve shqiptare dërguar Fuqive të Mëdha apo të shpallura publikisht, nga periudha e Lidhjes së Prizrenit deri në Kongresin e Lushnjës.

Në këto Memorandume, të hartuar nga shqiptarë brenda e jashtë Shqipërisë, kërkohen të drejtat kombëtare, autonomia dhe më pas pavarësinë e Shqipërisë, si dhe respektimi i vendimeve të Konferencës së Londrës. Duke përhëndetur drejtuesit dhe punonjësit e Bibliotekës Kombëtare për këtë ekspozitë, Kryeministri Berisha u shpreh se këto dokumente qëndrojnë në themel të përpjekjeve politike dhe diplomatike të shqiptarëve, për të ndërtuar shtetin e tyre të pavarur.

"Nga një vështrim i shpejtë, ajo që bie në sy është një zgjim i madh i shqiptarëve në të gjitha trojet etnike dhe shqiptarëve në diasporë e kudo që ndodhen. Kjo përbën një nga habitë e mëdha të kohës, pasi kombi, për shkak në një perandori tjetër, zgjohet me një ndërgjegje kombëtare që do ta udhëheqë atë dhe do ta frymëzojë në një betejë të madhe për pavarësinë e Shqipërisë", u shpreh Berisha.

Ai vlerësoi dokumentet e Lidhjes së Prizrenit, të cilat sipas tij, mishërojnë në mënyrën më të shkëlqyer idealin e bashkimit kombëtar, idealin më fisnik të shqiptarëve, ideal që do t'i frymëzojë ata, në çdo kohë, për zhvillim, për bashkim dhe horizonte të reja.

"Ky ideal, tha kryeministri Berisha, në fakt, frymëzoi shqiptarët, në çdo moment të vështirë të historisë së tyre, që të qëndrojnë së bashku dhe sot është më frymëzues se kurrë ndonjëherë. Ndaj, unë dua të shpreh nderimin tim, të të gjithë shqiptarëve, për autorët, etërit dhe frymëzuesit e këtyre dokumenteve, si dhe të falënderoj drejtuesit dhe punonjësit e Bibliotekës Kombëtare për ekspozimin e shkëlqyer të tyre. Ftoj qytetarët të njihen me këto dokumente, themele të shtetit të tyre të sotëm, themele të përpjekjeve të tyre për liri dhe dinjitet kombëtar", theksoi më tej ai.

Ambasadori i Komisionit Evropian në Tiranë, apel klasës politike

"Plotësoni kushtet për statusin, i përmendi edhe Hillari Klinton"

Një ditë pas vizitës dhe mesazheve për klasën politike të Sekretares Amerikane të Shtetit, Hilari Klinton në Tiranë, kreu i delegacionit të Komisionit Evropian në Tiranë, Ettore Sequi mbështet qëndrimin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, duke i bërë apel klasës politike të përbushë në kohë kriteret e mbetura. Nga Shkodra ku prezantoi Raportin e Progresit të Shqipërisë gjatë vitit 2011-2012, ambasadori i Bashkimit Evropian, vlerëson se Shqipëria ka bërë progres, duke kërkuar të vijohet në këtë frymë si dhe të përbushë disa nga pikat që

Kryediplotatja amerikane nënvizoi në Tiranë dy ditë më parë. Lidhur me kushtet e vendosura nga BE për marrjen e statusit nga ana e Shqipërisë, ai tha se shpreson se një gjë e tillë mund të bëhet realitet, por gjithsesi, nuk kërkon të jetë në rolin e parashikuesit. "Kam thënë që miratimi i statusit është i mundshëm, por ndërkohë vendimin e marrin të gjitha shtetet anëtare. Mendoj që marrja e statusit është diçka e mundshme dhe shpresoj që një gjë e tillë të ndodhë", nënvizoi ai.

Edhe pas 48 orësh, PS s'e ka kuptuar mesazhin e Klintonit

Njëri nga të përdorurit e kohëve të fundit të Edi Ramës, doli dje dhe ribëri një variacion mbi temën e kushtëzimit të ligjeve të statusit me gllabërimin e Qarkut të Fierit. Deklaratat e Majkos mund të konsiderohen si gjysmë-zyrtare, sa kohë publiku ka marrë vesh se edhe pas 48 orësh, kryetari i PS-së ende s'e ka kuptuar mesazhin e Hillari Klintonit

Apeli i Sekretares Amerikane të Shtetit, Hilari Klinton për përsheptimin e kursit reformator të Shqipërisë, në mënyrë që vendi t'i bashkëngjitet familjes së madhe evropiane, s'është prituri mirë nga lidhshipi i Partisë Socialiste. Kjo për faktin se në parlamentin shqiptar qëndrojnë prej disa muajsh 3 ligje me 3/5, të cilët presin votën konsensuale të Partisë së Edi Ramës.

Si të mos mjaftonin deklaratat publike të zonjës Klinton, fjalimi i saj emocional dhe frymëzues në Kuvend, Sekretarja Amerikane i rezervoi një takim kokë më kokë kreut të opozitës, Edi Rama për t'ia thënë në sy këtij të fundit se, qëndrimet refraktare të opozitës që ai drejton, po bëhen pengesë për të ardhmen evropiane të Shqipërisë. S'do mend të kuptohet se zotimi i Ramës për ta justifikuar çështjen dhe hedhur akuza në drejtim të mazhorancës, kanë si tentativë ta largojnë atë personalisht nga 'roli i bllokatorit', por në fakt kushtëzimi i integritetit për një çështje provinciale (siç është kryetari i Qarkut të Fierit) që s'i intereson të gjithë shqiptarëve dhe as nuk mund të quhet çështje e interesit kombëtar, nxjerr zbuluar të gjithë planin e brezit të dytë të nomenklaturës komuniste, për të lënë Shqipërinë pa statusin e kandidatit, për të tretin vit radhazi. Sigurisht që deklarata e Komisionerit Fyle për t'i rekomanduar vendeve anëtare të BE-së dhënien Shqipërisë të Statusit, s'është prituri me optimizëm në ngrehinën socialiste, pasi pasardhësit e Enver Hoxhës janë dhe mbeten koshientë për impenjimin e Partisë Socialiste në 3 ligjet e mbetura, të cilët kërkojnë edhe votat e



saj. Votimi i këtyre ligjeve, do ta nxirrte PS-në nga natyra e saj e vërtetë; ajo e bllokimit, izolimit dhe prapambetjes së Shqipërisë.

48 orë pas vizitës së Klinton në Tiranë, Partia Socialiste dhe Edi Rama ende s'e kanë kuptuar mesazhin e saj. Edhe pse, fjalimi në Kuvend, takimet me Presidentin Nishani, kryeministrin Berisha dhe madje edhe në takimin me vetë Rama, mesazhi ka qenë një dhe i vetëm; "interesat partiake prapa interesave kombëtare". "Shpresoj që ju do mund të gjeni rrugën tuaj për bashkëpunim të sinqertë e të qëndrueshëm. Ruajini besimet e ndryshme politike, besoni që mund të jeni një udhëheqës më i mirë se

sa tjetri. Politika kështu e ka. Nuk do merreshit me të nëse nuk do besoni këtë për veten. Por në fund, vendosja e interesave veti dhe interesave partiake prapa interesave kombëtare është ajo që iu kërkohet udhëheqësve demokratikë. Shqipëria dhe populli shqiptar meritojnë një vend në familjen evropiane të kombeve. Kjo është diçka jo vetëm për të mirën tuaj, por do ta bënte këtë kontinent më të paqte e të sigurt. Por që kjo të ndodhë, muajt që vijjnë paraqesin disa vendime kritike për ju që jeni në këtë sallë, për qeverinë tuaj dhe për popullin tuaj", ishte në vija të përgjithshme mesazhi i Hilari Klinton në Kuvendin e Shqipërisë. Por çfarë qëndrimi mbajti dhe po mban

Partia Socialiste? Jo më larg se dje, ish kryeministri Pandeli Majko u shpreh pa drojë e turp se, opozita s'do japë miratimin për 3 ligjet e mbetura, deri në zgjidhjen e qarkut të Fierit! "Në një mënyrë apo tjetër historia e shumë të metave lidhet me historinë e shumë të metave që ka kaluar ky vend. Nëse respektojmë ligjin, nëse respektojmë vendimin e gjykatave, mendoj se kjo do të prodhojë dhe një histori me pozitive se më parë", tha dje Majko.

Zhvillimet e pritshme nga ngrehina socialiste s'pritet të jenë pozitive, veçse përpos dominimit të injorancës dhe kokëfortësisë për t'i parashtruar çështjet sipas interesit personal dhe partiak të Edi Ramës, së pari është një kosto e rëndë politike, në radhë të parë për vetë fatet e tij politike. Dhe së dyti, përmes kësaj strategjie bllokuese, Partia Socialiste ecën e sigurt drejt një izolimi ndërkombëtar, si faktor negativ që dëmton interesat kombëtare të vendit.

Gjithsesi, pa shumë komente dhe arsytetime; dalja emergjente e Edi Ramës në konferencë për shtyp, pas takimit disa minutash me Sekretaren Amerikane të Shtetit, Hilari Klinton dhe nxitimi për ta cilësuar atë si moment 'ankesash' sesa vlerësimi i kontributit reciprok mes dy shteteve dhe dy kombeve; meritat e progresit evropian të Shqipërisë apo dhe implementimi i detyrimeve të integritetit; tregon qartë mendësinë e cekët dhe provincializmin politik të Edvinit.

Reagim i ambasadorit Sequi për ndarjen nga jeta të grevistit Lirak Bejko

"BE u bëri thirrje palëve të mos e shfrytëzonin situatën e dhimbshme për qëllime politike"

Kreu i delegacionit të Komisionit Evropian të Tiranë, Ettore Sequi shprehu dje ngushëllime për ndarjen nga jeta të Lirak Bejkos, një prej grevistëve që i vuri flakën vetes, gjatë grevës së urisë të disa ish të përndjekurve politik. Sequi theksoi se vetë-sakrificimi është gjithmonë një tragjedi, por theksoi ai, Bashkimi Evropian, Komisioneri Fyle përsëriti disa herë që greva të mos shfrytëzohej për qëllime politike.

"Kam vizituar grevistët e urisë gjatë grevës, sepse doja të kuptoja më mirë arsyet e saj. Kam vizituar Ndreca në spital për t'u informuar mbi gjendjen e tij shëndetësore

dhe për të shprehur dhembshurinë time. Në atë kohë, Komisioneri Fyle, drejtpërsëdrejti dhe nëpërmjet zëdhënësit të tij, shprehu shqetësimin dhe keqardhjen për situatën. Ai theksoi se situata e tyre duhet të jetë një prioritet imediat për të gjitha palët dhe inkurajoi qetësi dhe dialog konstruktiv në trajtimin e kësaj çështjeje. Komisioni Evropian bëri thirrje për dialog ndërmjet autoriteteve dhe organizatave të shoqërisë civile dhe ky dialog duhet të zhvillohet në kuadër të institucioneve demokratike dhe legjislativitetit përkatës. Ambasadorët e BE-së dhe Delegacioni i BE-së gjithashtu bënë një

deklaratë ku shprehin "dhembshurinë dhe shqetësimin për ngjarjet e rënda". "BE-ja u bëri thirrje palëve që të mos shfrytëzonin këtë situatë të dhimbshme njerëzore për qëllime politike dhe u njoh me ekzistencën e një plani kompensimi të përfshirë në ligjin e vitit 2007 dhe bëri thirrje për dialog për të trajtuar rastet individuale të cilat ky plan nuk i zgjidh. Ne të gjithë përdorim këto fjalë që janë kyç për Bashkimin Evropian: zbatim dhe dialog. Unë besoj se vetë-sakrificimi është gjithmonë një tragjedi. Kam bërë thirrje dhe deklarata nëpërmjet mediave për të ndaluar vetë-sakrificimin. Kam mbështetur iniciativën

e Presidentit, i cili u takua me përfaqësues të grevistëve të urisë. Shpreh ndjenjat e thella të simpatisë njerëzore, hidhërimit dhe keqardhjes për humbjen e të ndjerit Lirak Bejko. Mendimet e mia janë me familjen e të ndjerit", thuhet në reagimin e ambasadorit Sequi.

Ish-i përndjekuri politik Lirak Bejko ndërroi jetë në një spital në Bari. Ish-grevisti i urisë, i cili tentoi të vetëflijohet duke u vetëdëgjur nuk i ka mbijetuar plagëve të marra në mbi 50 për qind të trupit. Lirak Bejko e ndërmori aktin e vetëflijimit në ditën e 19 të grevës së urisë së ish-të përndjekurve.

Berisha, apel opozitës të votojë reformat, për të mos dëmtuar integrimin

Një ditë pas vizitës së suksesshme në Shqipëri të Sekretares Amerikane të Shtetit, Hillari Klinton, kryeministri Sali Berisha u shpreh dje se mesazhi i SHBA-ve, për shqiptarët në 100 vjetorin e pavarësisë ishte një thirrje frymëzuese për tu bashkuar së bashku për interesat kombëtare. Kreu i ekzekutivit ftoi kreun e opozitës që nisur nga ky mesazh i përcjellë nga Sekretarja Klinton, të bashkëpunojnë për procesin e integritimit, si interesi më i mirë i të gjithë qytetarëve shqiptarë.

Sipas tij, garantoj se qeveria do të bëjë gjithçka për të gjetur konsensusin më të madh me opozitën dhe me të gjithë faktorët, për të konsoliduar më tej vlerat e përbashkëta të cilave iu besojnë. "Mesazhi i Sekretares së Departamentit të Shtetit, Hilary Klinton për shqiptarët në 100 vjetorin e pavarësisë ishte një thirrje frymëzuese që të bashkohen për interesat e tyre kombëtare. Ajo ilustroi këtë thirrje frymëzuese me aspekte personale të karrierës së saj të shkëlqyer. Dhe unë dua ta garantoj se kjo qeveri do të bëjë gjithçka për të gjetur konsensusin më të madh me opozitën, me të gjithë faktorët, në mënyrë që të konsolidojmë më tej vlerat të cilave iu besojmë. Sekretarja e Shtetit theksoi edhe këtu në bisedime, por edhe në Parlament, rëndësinë që kanë zgjedhjet e ardhshme. Unë e garantova Sekretaren Klinton se zgjedhjet ardhshme do të jenë zgjedhje të lira, të ndershme dhe brenda të gjitha standardeve më të mira ndërkombëtare. E garantova sepse qeveria ka një vullnet të hekur të punojë në këtë drejtim por shpreha bindjen se opozita është thellësisht e angazhuar që të ketë zgjedhje të lira dhe të ndershme. Gjithashtu kërkova që të ketë sa më shumë vëzhgues nga SHBA-të në zgjedhjet e ardhshme. Sekretarja e Shtetit Klinton, solli mesazhin e një pune të përbashkët që duhet të bëjmë në projektin më madhor që ka kombi sot, në projektin e integritimit në BE. Unë e garantova se qeveria do të bëjë gjithçka dhe se këtë proces e konsideron kryekëput të bazuar në meritë, e konsideron një proces jetik, i cili i bën qytetarët shqiptarë, më të lirë, më të begatë, më të sigurt, ndaj e informova gjerësisht për tërësinë e reformave të ndërmarrë në këtë drejtim dhe rezultatin e këtyre reformave në të gjitha fushat. Uroj dhe dëshiroj që ky mesazh të lexohet bashkërisht nga të gjithë shqiptarët, nga forcat politike të punojmë së bashku për të përmbushur detyrimet tona në procesin e integritimit", u shpreh Berisha. Kryeministri veçoi 3 ligjet e Komisionit Evropian, të cilët presin votën e opozitës në Kuvend. "Dua të theksoj se janë tre ligje që presin në parlament. Asnjëri prej tyre nuk mbush një vakum, ligjet ekzistuese janë ligje thellësisht demokratike, pra në këtë sens çdokush mund të mendojë që këto nuk mund të jenë pengesë, por ky është arsytim i gabuar sepse vetë fakti që nuk i voton ligjet që kërkohen me qëllimin më të mirë nga KE është i mjaftueshëm për mendimin tim, për të venë në dyshin seriozitetin e shqiptarëve në procesin e integritimit, sepse

Kreu i Ekzekutivit i bën thirrje opozitës parlamentare t'i përgjigjet apelit të aleatit të madh të shqiptarëve, sekretares Klinton, dhe të votojë 3 ligjet e bllokuara në parlament, të cilat po mbajnë peng formalizimin e vendimit për marrjen e statusit kandidat për në BE
Deklarata e Berishës: "Zgjedhjet ardhshme do të jenë të lira dhe demokratike"



ne rëndom tentojmë të kërkojmë shkaqet tek të tjerët. Çfarë po kërkojmë? Votoni tre ligje, ligje demokratike që konsolidojnë më tej pushtetin gjyqësor administratën publike dhe rregullat në parlament. Atëherë përse nuk votohen? Unë e ftoj zotin Rama në frymën e këtij mesazhi. Le të punojmë bashkërisht për gjërat që na bashkojnë dhe integrimi na bashkon ne. Sigurisht që kemi dallime, por pikërisht qershori është muaji që do të votohen dallimet. Në të përbashkëta fitojnë të gjithë, nuk fiton kapital më të madh qeveria, as opozita, fitojnë qytetarët, fiton qeveria, fiton opozita. Kemi dallime, ndaj shkojmë në zgjedhje, ti paraqesim dallimet tona qytetarëve dhe ata do të vlerësojnë se për cilat platforma të votojnë", tha ai.

Më pas ai e cilësoi progresin reformator të Shqipërisë, edhe si dëshmi vendimtare për të mos dëmtuar procesin e integritimit. "Ndaj dhe e shfrytëzoj këtë rast ti përgjigjemi thirrjes së KE-së për të votuar ligjet në parlament, si një dëshmi e vullnetit të hekur për të mos dëmtuar procesin e integritimit, proces kymenjë mbështetje masive nga qytetarët shqiptarë, por edhe një hap i domosdoshëm i shprehjes së respektit të mirënjohjes ndaj mikeshës së madhe, mesazheve që solli nga kombi, qeveria dhe vendi i saj i madh mik. Do të ishte një veprim i qytetarëve, i përgjegjshëm që e presin të gjithë qytetarët shqiptarë", tha kryeministri.

Sekretarja amerikane e Shtetit, Hilari Klinton, duke konfirmuar mbështetjen që SHBA i jep Shqipërisë në aspiratat evropiane, i bëri thirrje klasës politike që të punojnë për 3 pikat e rekomanduara nga KE. "Shpresoj që edhe ju do gjeni rrugën për bashkëpunim të sigurt. Interesat partiake duhet të jenë nën ato kombëtare", ishte apeli i sekretares Klinton, drejtuar klasës politike shqiptare.

► Vizita e Hilari Klinton, mesazhi më i fuqishëm i miqësisë midis dy vendeve tona

Vizita në Tiranë e Sekretares Amerikane të Shtetit, Hillari Klinton, ishte kryefjalë e mbledhjes së djeshme të Këshillit të Ministrave.

Kryeministri Sali Berisha vlerësoi se vizita e Klinton përbën ngjarjen kulmore në festimet e përvjetorit të 100-të të Pavarësisë. Sipas tij, Klinton çeli siparin e festimeve si dhe përcolli mesazhin e fortë të miqësisë së përvjetshme mes dy kombeve. "Kryefjalë e kësaj mbledhje nuk mund të jetë gjë tjetër veçse një mirënjohje shumë e thellë në emër të qytetarëve shqiptarë për vizitën e Sekretares së Shtetit Klinton, në Tiranë, vizitë që përbën ngjarjen kulmore në festimet e 100 vjetorit të pavarësisë. Ndaj dhe dua ta falënderoj shumë për zemërsisht Sekretaren Klinton, Qeverinë e SHBA-ve, presidentin Obama për këtë vizitë historike të realizuar në një vit kurorë, të një shekulli pavarësi. Sekretarja Klinton hapi dje, siparin e festimeve të 100 vjetorit të pavarësisë së Shqipërisë me mesazhin më të fuqishëm të miqësisë midis dy vendeve dhe dy kombeve tona. Ajo solli mesazhin e miqësisë së kombit të madh amerikan, qeverisë së SHBA-ve, miqësi, e cila është e konkretizuar gjatë një shekulli me akte dhe vendime madhore të këtij vendi mik për Shqipërinë dhe shqiptarët në tërësi", u shpreh kryeministri Berisha.

Kreu i qeverisë theksoi se populli shqiptar i është mirënjohës popullit mik amerikan, pasi do të ishte presidenti amerikan, Woodrow Willson ai që do të ndalonte copëtimin e trojeve shqiptare, duke mbështetur parimin e vetëvendosjes dhe mëvetësisë për një ndër kombet më të lashtë në kontinentin Evropian. "Në një ndër kohërat më të vështira të kombit shqiptar kur konferencat ndërkombëtare, nga të cilat me shumë

të drejtë Ati i Shenjtë do të thoshte se e kanë përzënë Zotin nga ato salla dhe po bënin ndarje dhe copëtimet më të tmerrshme të trojeve shqiptare të një kombi ndër më të lashtit në kontinent. Do të ishte presidenti Willson që do të shpallte të drejtën dhe parimin e vetëvendosjes për popujt e vegjël, si një e drejtë të cilën ai dhe fuqia e shtetit të tij e mbështesnin plotësisht. Do të ishte presidenti Willson ai që do të hidhte poshtë projektin e copëtimet të mëtejshëm të trojeve shqiptare dhe të asgjësimit 'de facto' dhe 'de juro' të shqiptarëve të Shqipërisë si nocione politike në kontinent dhe do të jepnin më pas një ndihmë të madhe në anëtarësimin e Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve dhe zhvillimin e degëve të ndryshme të arsimit, të bujqësisë dhe një seri degësh të ekonomisë shqiptare", tha ai.

Miqësia shqiptaro-amerikane, tha kryeministri Berisha, vijoi edhe gjatë Luftës së Dytë Botërore, atëherë kur pushtimi nazist ishte shtrirë në të gjithë Evropën, shqiptarët qëndruan në anën e historisë duke luftuar kundër nazistëve. "Gjatë Luftës së Dytë botërore shqiptaret me luftën e tyre qëndruan në anën e historisë dhe aleatët anglo-amerikanë mbështetën fuqishëm rezistencën e armatosur të shqiptarëve, e mbështetën atë me ndihma të mëdha materiale, e mbështetën me armatime, me ekspertë dhe specialistë të shquar, elitë të trupave britanike, mbështetën parimin që të armatohet çdo grua dhe burrë që kërkon të dalë në fushëbetejë dhe të luftojë me pushtuesin", theksoi kryeministri. Ndërsa do të veçonte se, presidenti i 33 amerikan, Harry S. Truman përcaktoi Shqipërinë si vendin në të cilin duhet të ndërmerreshin të gjitha veprimet për përmbyshjen e diktaturës mizore të Enver Hoxhës e instaluar në Shqipëri vetëm pak kohë pas kapitullimit të boshtit nazifashist. Do të ndërmerrete një operacion të

gjerë. Në vitin '90-të, tha Berisha, dihet se mesazhet e lirisë për shqiptarët brenda dhe jashtë kufijve, e vërteta është se erdhën nga Uashingtoni dhe kjo është e paharruar".

Sipas kryeministrit, Presidenti George Bush që do të vendoste linjën e kuqe, të cilën do ta ndërmerrete dhe presidenti Klinton për ushtritë e kasapit të Ballkanit në Kosovë. "Presidenti Bill Klinton në një betejë historike për shqiptarët, por dhe për Aleancën e Atlantikut të Veriut do të udhëhiqte këtë Aleancë në këtë luftë me Sadamin e Ballkanit për çlirimim e Kosovës dhe do të firmosej në qershor të vitit 1999 'Marrëveshja e Kumanovës', marrëveshje që asgjësoi në mënyrë përfundimtare Kumanovën e fillimit të shekullit, Kumanovën e cila shënoi fillimin e barbarive më të mëdha ndaj kombit shqiptar në përputhje me copëtimet që i ishin bërë trojeve shqiptare. Presidenti George Bush përcaktoi mbështetjen e madhe ndërkombëtare për pavarësinë e Kosovës dhe anëtarësimin e Shqipërisë në NATO", theksoi Berisha.

Miqësia shqiptaro-amerikane, tha kryeministri, vijoi edhe anëtarësimin e Shqipërisë në NATO në 2009-ën dhe mbështetjen e Pavarësisë së Kosovës në 2008-ën. "Presidenti Obama finalizoi aktin e anëtarësimin të Shqipërisë në NATO dhe ai dhe administrata e tij mbështesin fuqishëm përpjekjet e shqiptarëve për ndërtimin paqes, stabilitet dhe të demokracisë aty ku jetojnë. Pra ky 100 vjeçar, ka si arritje më madhore për kombin shqiptar, faktin që shqiptarët sot, janë të lirë kudo që ndodhen në Shqipëri, në Kosovë dhe kudo dhe shqiptarët në Shqipëri janë anëtarë të NATO-s. Arritja e dytë më madhe e kombit shqiptar është se ata e festojnë 100 vjetorin e pavarësisë, si aleatë besnik të SHBA-ve. Mesazhi i Sekretares së Shtetit për kombin shqiptar ishte për një mbështetje të fuqishme në qindra e qindra vite që vijnë, për një miqësi të qëndrueshme dhe kjo bën krenar çdo shqiptar dhe njëherë theksoj se në këto 100 vite kjo miqësi është një nga arritjet më të mëdha dhe më kryesore në historinë e lirisë së shqiptarëve", tha më tej kryeministri Berisha.

Duke iu referuar fjalimit të Klinton në Kuvend, kreun e qeverisë tha se ai ishte fjalimi më i veçantë, më miqësor, por dhe më i bukur që shqiptarët kanë dëgjuar ndonjëherë në këto 100 vjet. "Shprehu vlerësimin më të madh për përpjekjet e shqiptarëve për ndërtimin e demokracisë dhe të shtetit ligjor, vlerësimin më të madh për arritjet në këtë përpjekje, natyrisht në të cilat ata kanë patur ndihmën dhe solidaritetin e SHBA-ve dhe të vendeve mike në Evropë dhe në botë, por njohja dhe vlerësimi nga sekretarja Klinton, nga demokracia e madhe amerikane dhe kombi i madh amerikan i këtyre arritjeve përbën një inkurajim, një frymëzim për të gjithë shqiptarët në mënyrë që të ecin në konsolidimin e mëtejshëm të tyre. Kam pasur dhe kam bindjen më të thellë se mënyra, më dinjitoze, më e shkëlqyer e vlerësimit të kësaj mbështetje të SHBA-ve, të miqve të tjerë tanët, është konsolidimi i vlerave të përbashkëta që ndajmë me kombin e madh amerikan dhe vende të tjera mike", u shpreh ndër të tjera, kryeministri Sali Berisha.

Nga Ilirian Dahri

Qeveritë e vendeve anëtare të Bashkimit Europian po bëjnë gjithcka për rritjen ekonomike të vendeve të tyre. Natyrisht objektivi kryesor është pikërisht rritja ekonomike sepse fill pas saj problemet e tjera do të ishin tërësisht të kapërcyeshëm. Një ndër këto vende është padyshim edhe vendi fqinj i Italisë. Në vendin fqinj janë kryer një sërë reformash që kanë patur si objektivi kryesor, rritjen ekonomike për të ulur në këtë mënyrë edhe papunësinë sidomos atë të rinjve. Natyrisht edhe rritja e besimit është një faktor i rëndësishëm jo vetëm për Romën por edhe për kryeqytetet e tjera europiane. Drejtori i marrëdhënieve me jashtë të Fondit Monetar Ndërkombëtar, Gërry Rice ka dashur të ndalet tek Eurozona dhe problemet e saj, në deklaratat e tij në prag të fundjavës, sidomos në vendet që paraqesin më shumë probleme. Gjithsesi drejtori Rice ka vlerësuar punën e qeverisë spanjolle sidomos me reformat duke deklaruar ndërkaq se "vetëm qeveria spanjolle mund të kërkojë ndihmë" në rast nevojë. Në të njëjtën kohë Drejtori i marrëdhënieve me jashtë të Fondit Monetar Ndërkombëtar, Gërry Rice ka folur edhe për Greqinë. Sipas tij qeveria greke dhe Trojka (Fondi Monetar Ndërkombëtar, Bashkimi Europian, dhe Banka Qendrore Europiane) i kanë ende të hapura negociatat për temën e financimeve që do t'i jepet Greqisë. Gjithmonë sipas Rice, Greqia dhe kreditorët duhet të gjejnë një "marrëveshje mbi kushtet e financimit" që të jenë brenda një niveli borxhi të menaxhueshëm. Por hera-herës problemet e Greqisë duken me të vërtetë të vështira për qeverinë greke e cila duhet të përballlet edhe me një koalicion të brishtë. Ndërkaq pikërisht një prej kushteve të përcaktuara nga trojka ka qenë edhe ulja e pensioneve. Duhet rritur mosha e pensionit nga 65 në 67 vjeç, por ndërkaq flitet se kjo është kundër Kushtetutës e cila shprehet qartë për dinjitetin e individit dhe barazinë përpara ligjit. Kjo do të sillte



Eurozona, mes reformave dhe polemikave

si pasojë një sërë ankesash në gjykata. Nga ana tjetër kjo rrit edhe më tepër tensionin në panoramën greke. Në fakt pensionet janë reduktuar me 25% që prej vitit 2010 dhe kjo shifër përfaqëson gjysmën e 9,37 miliardëve të kursyer që qeveria e Samaras e cila po kërkon që t'i ketë për paketën e ndihmës të vitit 2013, sipas marrëveshjes me kreditorët. Situata duket e komplikuar edhe për vetë qeverinë e cila doemos kërkon të zhbllokojë paketën e ndihmave prej 31 miliardë euro. Pa këtë paketë ndihmash vendi fqinj do të kishte para vetëm për disa javë. Si për të shtuar akoma dhe më shumë tensionin parashikimet mbi borxhin janë akoma dhe më të zymta. Në

vitin 2013, borxhi do të arrijë në 189% të Gdp, ndërsa në vitin 2014 do të arrijë në 190%. Si pasojë e parashikimeve edhe bursa greke ka shënuar një ditë negative. Janë parashikuar një sërë shkurtimeve por nga ana tjetër reforma e punës është kundërshtuar nga e majta radikale dhe 16 deputetët e saj nuk do të votonin propozimin qeveritar. Sidoqoftë dy partitë e mëdha kanë ende gjysmën e votave 159 në 300 deputetë. A do të mjaftonte? Jo më larg se dje një deputet i Pasok-ut është tërhequr, M. Kassis e ka braktisur këtë grup parlamentar. "Që këtej e tutje jam i pavarur" - ka deklaruar Kassis. Në të njëjtën natë, pas një mbledhje të gjatë edhe pse socialistët

kishin pranuar propozimet e qeverisë, pesë prej tyre ndiheshin akoma të pasigurtë. Por në këtë situatë ka bërë të sajën edhe e ashtuquajtura lista Lagarde, një listë kjo e fundit me emrat e më shumë se 2 mijë qytetarëve grekë që kanë llogaritë e tyre në bankën zviceriane Hsbc të Gjenezës. Në ciklon janë rreth 300 deputetë. Papakostantinou, ish ministër i Financave të qeverisë Papandreu dhe Venizellos ish ministër i Financave. Papakostantinou mori nga një ministër francez një cd në vitin 2010 dhe ja dorëzoi një shefi të Financës i cili nga ana e tij meqenëse lista kishte edhe dy emra ministrash nuk i shko

deri në fund kësaj çështje. Aktualisht, sipas ministrit të Financave të Greqisë, Stournaras ky dokument nuk gjendet më ministrinë e Financave të vendit fqinj. Ndoshta personi që ndodhet më në vështirësi është sekretari i Pasok-ut, Venizellos sepse rreth 36 deputetë të tij kanë kërcënuar se nuk do të votojnë marrëveshjen me trojkën për masat shtrënguese nëse më parë nuk i shkohet deri në fund listës Lagarde.

Nga Kostaq Xoxa

Çështja pronësore është njëra nga kërkesat që vendi ynë duhet të plotësojë, për të përfutur Statusin e vendit kandidat për në BE. Ndërkaq kemi një thënie vërtet interesante: "Nuk ka pronarë të paligjshëm. Ka vetëm pronarë". Por ja që kjo thënie ka si autor një person të pabesueshëm: Edi Ramën! Është i pabesueshëm se është kontradiktore. Sepse është i pëshqjelluar nga sindroma e Haxhi Pishmanit. Le të shohim edhe thënien tjetër të tij, përballë sekretarit të përgjithshëm të Shoqatës së Pronarëve, z. Agim Torro: "Ti edhe që të më drejtohes për pronat? Shkoni t'i gjeni ato te Partia juaj e djathtë!". Përveç harbutësisë që përmban kjo thënie e dytë, është e tepërt të dallojmë se cila nga këto dy thënie duhet quajtur e mirëqenë. Se të dyja janë të të njëjtit person. Pikërisht të kreut të PS-së, nëse një inkohent si ai ka një mendim të caktuar. Përndryshe do t'i këshillohet qiramarrësit, - që janë të partisë së tij, - që të mos i hynin një gjyqi, që s'mund të merrte një vendim që të binte ndesh me Kushtetutën, domethënë me mohimin e të drejtave themelore të të drejtave të njeriut. Kuptohet se vendimi i gjykatës i hodhi poshtë iluzionet e Edi Ramës për mendimet e tij të hamendësuar si të drejta, në ballafaqim me forcën politike në pushtet, të cilën ai gati-gati e quan si armike, jo si kundërshtar politik. Është, pra, një nga dështimet e tij të radhës, si politikan. Në këto ujëra të turbullta mundohet të notojë kurdoherë një njeri konfliktual si E. Rama, që ka thënë, prej kohësh se nuk është politikan! Por a ka në të gjithë rruzullin ndonjë kryetar partie që s'është politikan? Është tjetër gjë se ai s'e kupton (ose, më saktësisht, bën sikur s'e kupton) se është një politikan i së keqes. Të gjithë politikanët kanë një staf apo një elitë njerëzish rreth tyre, me të cilët konsultohen. Ai, me cilët u konsultua për atë "originalitetin", i cili u përplas si një risi e hidhur befasuese, që të bllokoi valët e të gjithë celularëve, pjesëmarrës në sallë, në njërin nga mbledhjet më të rëndësishme? Ai është i paparashikueshëm edhe brenda radhëve. Këto të papriturat "black-

Qiramarrësit në gjyq, si cjapi te kasapi!

out"-ëve revoltuan të gjithë pjesëmarrësit, por vetëm disa dolën hapur në mediet, duke kritikuar ashpër shefin e tyre. Në kujtimet e një sekretari të Byrosë Politike të Stalinit, Boris Bazhanovit, vetëm ky dhe Mehli si kishin të drejtë të hynin në zyrën e Stalinit, pa trokitur. Bazhanovi u arratis në botën perëndimore. Përndryshe do ta pësonte si ai tekniku çek me aftësi të jashtëzakonshme, që i kishte bërë një punë që askush nuk do të kishte mundur dot ta kryente, në zyrën e Stalinit. Në Kujtimet e tij, të botuara pas shumë vitesh në Perëndim, për të kursyer jetë njerëzish, Bazhanovi tregon: "Hyra në zyrën e tij dhe mbeta pa mend në kokë kur pashë Stalinit që s'po bisedonte nëpërmjet telefonave që kishte në tavolinë, por pashë menjëherë kordonin e dorezës që kishte vënë në vesh, që zgjatej poshtë tavolinës. M'u deshën vetëm disa sekonda që të vëreja se poshtë tavolinës ndodhej një aparat me anë të të cilit, Stalini dëgjonte bisedat ndërmjet anëtarëve të B.Politike dhe të K.Q. Çeku e pagoi shtrenjtë shpikjen e tij të jashtëzakonshme. Iu dha urdhër Jagodës ta ekzekutonte menjëherë, se kishte gjasma të dhëna nga KQ i partisë çekoslovakë, se ishte spiun!". Bazhanovi i kërkoi aty për aty të falur Stalinit se kishte harruar bllokun e shënimeve. Për të mos pasur fatin e çekoslovakut. Ndërsa një natë pa gjumë dhe ia mbathi kinse për gueti. Natyrisht, si një person pranë zyrës së Stalinit, u lejua të kalonte në një pyll kufitar, nga i cili doli përtej. Një aventurë e vërtetë! A thua se Edi Rama paska gjetur një usta me aftësi të jashtëzakonshme, si ai ndjesë pastë çeku, për të bllokuar celularët e të gjithë të pranishmëve të sallës? Kjo mbetet mister, ndërsa fakti në vetvete nuk mbetet i remë. E pohojnë të gjithë të pranishmit. Dhe E. Rama nuk mund t'i akuzojë të gjithë ata se... gënjejnë! Kur thotë se "ia vodhën votat" (akuzë kundër mazhorancës), do të bënte mirë të përgënjeshtronte forumet e grave socialiste në Sarandë, për marifete në zgjedhjet e

brendshme, "të komanduar angallat", për të cilat shumë prej grave socialiste sarandjote dhanë dorëheqjen nga partia e E. Ramës, domethënë nga PS-ja. Mjaft një deputetë e kryetarit janë zëvendësuar me njerëz të besueshëm. Në të vërtetë, kanë lënë "vullnetarisht" mandatin e tyre. Shkurt, brenda radhëve, po krijohet një oligarki partiake dhe shumë nga pakënaqësitë po dalin jashtë sekretëve të përbrendshme, të cilat e kanë zvetënuar prej kohësh atë "transparencën" për të cilën mburrej dikur kryetari, me rast e pa rast, që përkufizohej nga shumë kush si njeriu i obskuranizmit. Serioziteti i zgjedhjeve të Konventës Kombëtare të I. Metës, është një leksion mësimdhënës krahasues për mjaft nga ata që mendojnë me gjykimin e tyre, brenda radhëve të PS-së së Ramës. Kësisoj edhe ajo shprehja e rëndomtë "M'i vodhën votat" po tingëllon gjithmonë e më tepër, si groteske. Që të shqyrtojmë edhe njëherë atë ballafaqim të qiramarrësve me pronarët e ligjshëm, do të na duhet të bëjmë disa këqyrje, që na duken të natyrisht: Si nuk mendoi, qoftë edhe për një çast, se pronarë të ligjshëm, të vegjël, të mesëm, të mëdhenj, janë aq të shumtë, sa përbëjnë një elektorat më vete? Një bashkësi zgjedhësisht, sidomos të vegjël e të mesëm, janë aq të shumtë, sa mund t'ia mehin pjatën e tij të balancës, që është gjithmonë në rënie, për shkak të muhshisë së tij të pafrenueshme, asaj prepotence inatçore që po i shkakton rruhdjen e vazhdueshme të aleancës me partitë pa zgjedhës, pa asnjë përfaqësues në parlament... Këtyre u del në ëndërr ai ushqimi me lugë të zbratur, si edhe ai lokucioni popullore "Fjala e mirë e guri në trastë". Nëse gënjeshtro i ka këmbët e shkurtra, e njëjta gjë mund të thuhet edhe për demagogjinë. "Kurban" i tij, paçka se është shitur me listë, si "Veprat" e Enverit, është bërë i palexueshëm për periudhat e pambarueshme e të gjata, kur shenja e pikësisht, pika, e gjen pikën pasardhëse, pas 34 rreshtash të librit! (shih f. 107, që të bindeni)

. Sido që mezi lexohet, aty mund të merret një mësim djallëzor nga pronarët e rinj, të privilegjuar në kohën e diktaturës dhe pas saj, që i ranë për bukuri qyllit me ato pagesat sa për mundësinë e një kafeje me shoqërimin e një uiski, në muaj. Ndërsa pronarët e ligjshëm vinin në kafe vetëm dy herë në muaj, për një kafe pa bisht, ku gjenin të shtuar në bankete të babëziturish "pronarë" thujse pa pagesë në shtëpitë e tyre. Në këto shtëpi, në rastin më të mirë, të zotët e shtëpisë kishin përfunduar në katë (bimëzat) tërë lagështirë, në të cilat u sëmureshin fëmijët për kushtet higjienike katastrofike.

Pikërisht një muaj e gjysmë më parë u hap zyrtarisht ky problem i cili, në Parlament, arriti kulmin e mungesës tërësore të parimeve të të drejtave kushtetuese njerëzore, "të të padëshiruarve", të plaçkitur në format nga më cinikët prej diktaturës. Në rastin më të mirë, u futën në bodrumet e shtëpive edhe ish-të pasurit, në përgjithësi: tregtarët, paçka se kishin ndihmuar materialisht lëvizjen n.çl. Por uzbritën bodrumeve edhe pengjet mesjetare, si hakmarrje për një arratisje të ndonjë të afërti, qoftë edhe të largët, gjer në intrigat për t'ia rrëmbyer banesën tjetrit. Të futurit në bodrume, duhej të ishin, madje, të kënaqur. Dhe gjurmoheshin që të mos ishin qejfmbetur. Sepse, përndryshe, do të bëheshin kontingjent për internim, gjithmonë në rastin më të mirë. Burgjet i prisnin një pjesë më të madhe prej tyre. Kryetarja e Parlamentit, duke folur për aktin normativ, kishte thënë se Socialistët i urrejnë pronarët. Ministri Sokol Ollldashi, që kishte vuajtur internimet e një regjimi mizor, kishte paraqitur në atë seancë parlamentare 28 emra ish-persekutorësh, ish-hierarkë të privilegjuar dhe biznesmenësh të majmnr socialistë, me familjet në Itali, në Greqi, në Amerikë e në Kanada, që i mbajnë shtëpitë e pronarëve të ligjshëm, me raste konkrete gjashtë dhomash, me një qira simbolike. Këto shtëpi të rrëmbyera ishin ose

të mbyllura me dryn, ose me banim prej një familjari të vetëm, që ndiheshin si vetmuar në ato vende ish-armiq dhe që duan të bëjnë qyfyre tërë ditën kafeneve shqiptare, me tabela të huaja. Tymnaje ideologjike për "drejtësinë" e kallëpit enverist që do të vërë në vend Rama, që i ka thënë Kryetarit të shoqatës mbrojtëse të pronave, në vitin 2007: "ik qërohu te partia jote!". Deputeti Gerti Bogdani, duke folur për aktin normativ, kishte thënë se ky akt "vë në dukje të drejtën e mohuar të mijëra familjeve tiranase dhe shqiptare, që nuk kanë gëzuar, shfrytëzuar e zhvilluar pronën e tyre". Foli edhe për "agallarët" e sotëm që i kanë thujse gratis shtëpitë e gëzuara prej 68 vitesh nga nomenklatura komuniste e kohës". Na kujtohen ata që kishin zënë vend në një kafënë luksi dhe dëgjoheshin kapadallëqet e tyre nga të tjerët. Për të mbrojtur padrejtësisht shtëpitë e uzurpuara prej tyre, kishin luajtur edhe kartën e Edi Ramës: Atë të të qenurit... fukara! A nuk ishte edhe Rama në shtëpi me qira? Në të vërtetë, në këtë seancë parlamentare socialistët u diskredituan si rrallëherë. S. Ollldashi përmendi "protestën" e atyre që s'u ngopën nga bëmata në kohën e Enverit, por edhe me shtëpitë thujse falas, ndërsa pronarët e ligjshëm rrinin ende bodrumeve. Dolën përfituesit, me emër e mbiemër. Njëri sigurim, mizori që hidhte viktimit nga dritarja dhe thoshte se u vetëvra. Të tjerët: ish-ministra të kohës së diktaturës; ish-shefa të policisë; hierarki të sigurimit; kryetarë gjykatash kriminale; sekretarë të parë komitetesh të Partisë në rrethe... Përfundimisht, Edi Rama ka humbur plotësisht besimin e pronarëve të ligjshëm dhe të ish-të përmjekurve politikë. Me këta të fundit kuptojmë ata të shoqatave, jo individë në shërbim të tij. Edhe ndër pronarët mund të jenë disa që ushqejnë iluzione. Por këta individë nuk përfaqësojnë rregullin, por përjashtimin. Dhe dihet se përjashtimet konfirmojnë rregullin.

Presidenti Bujar Nishani nis të hënën konsultat me partitë politike për datën e zgjedhjeve

Axhenda, takime të veçanta me krerët e grupeve parlamentare

E hëna do jetë një ditë e ngjeshur takimesh për kreun e shtetit Bujar Nishani, i cili do të zhvillojë konsultime të veçanta me përfaqësuesit e partive politike parlamentare, për caktimin e datës së zgjedhjeve të ardhshme. Takimin e parë Nishani do ta zhvillojë në orën 10:00 me

kreun e grupit Parlamentar të Partisë Demokratike Astrit Patozi, në orën 11:00 është caktuar takimi me kreun e Grupit Parlamentar Socialiste Gramoz Ruçi. Takimi me kreu e Grupit Parlamentar të LSI-së Lefter Koka është caktuar ora 12:00, një orë më vonë do takohet me

kryetarin e Partisë Republikane Fatmir Mediu, me pas do presë Vangjel Dule e PPDNJ-së, ndërsa takimi i fundit është në orën 15:00 me kryetarin e Partisë Drejtësi, Integrim dhe Unitet Shpëtim Idrizi. Pas këtyre konsultimeve kreu i shtetit do dekretojë datën e zgjedhjeve të vitit 2013-së.

E Hënë/ Axhenda e takimeve

Ora 10:00 – Takim me Kreun e Grupit Parlamentar të PD, Astrit Patozi
Ora 11:00 – Takim me Kreun e Grupit Parlamentar të PS, Gramoz Ruçi
Ora 12:00 – Takim me Kreun e Grupit Parlamentar të LSI, Lefter Koka
Ora 13:00 – Takim me Kryetarin e PR, Fatmir Mediu
Ora 14:00 – Takim me Kryetarin e PBDNJ, Vangjel Dule
Ora 15:00 – Takim me Kryetarin e PDI, Shpëtim Idrizi.

EURALIUS dhe Ministria e Drejtësisë, reformë për modernizimin e administratës gjyqësore

Halimi: Opozita të miratojë ligjet me 3/5 për statusin, reforma në drejtësi, proces i gjatë dhe i vështirë

Misioni EURALIUS në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë lançuan dje një nga reformat më të rëndësishme të sistemit gjyqësor atë të administratës gjyqësore. Nisma ka për qëllim diskutimin mbi propozimet për një ligj të ri për administratën gjyqësore. Sipas opinionit të disa ekspertëve ndërkombëtarë një nga problemet kryesore në gjykatat shqiptare është mungesa e procedurave të qarta dhe transparente për rregullimin ligjor të administratës së gjykatave sipas standardeve Evropiane.

Nga ana e tij, ministri i Drejtësisë, Eduard Halimi e konsideroi projektligjin si mënyrën më të mirë për të modernizuar administratën gjyqësore e cila i jep asaj një status të ri, që mbron, përforcon dhe garanton administratën e gjykatave. "Reforma e administratës gjyqësore, është një nga çelësat kryesorë të forcimit të besimit të publikut tek drejtësia. Takimin e parë me sistemin e drejtësisë, qytetarët e kanë me administratën gjyqësore. Performanca e saj është thelbësore në klimën e besimit të qytetarëve tek sistemi. Reforma që do të prezantohet edhe në këtë Konferencë mban në konsideratë tipologjinë e organizimit të pushtetit gjyqësor, që për nga pikëpamja e organizimit, ku çdo gjykatë drejtohet me kompetenca të plota administrative nga Kryetari i Gjykatës. Rregullat e reja pritet të krijojnë një fushë intensive bashkëpunimi, nën parimin e roleve dhe përgjegjësi të ndara, midis kryetarit dhe kancelarit të gjykatës. Përcaktimi i përgjegjësiave merr rëndësi parësore sepse i shërben rritjes së efektivitetit dhe përmirësimit të ndjeshëm të shërbimeve ndaj qytetarëve. Unë jam i bindur se ky



projektligj fillestar do të ketë diskutime, sepse çdo reformë, sidomos kur ecet në një rrugë tërësisht të re si kjo e sotmja, përballat me diskutime dhe skepticizëm. Por jam i bindur se kjo reforme do të gjejë mbështetjen e drejtuesve të gjykatave në radhë të parë, të cilët do të ngrihen në lartësinë e liderit, jo për të diskutuar mos lëvizjen nga status quo-ja por për të diskutuar reformimin, për të diskutuar arritjen e standardeve më të mira evropiane", u shpreh ministri Halimi.

Sipas tij, reforma në sistemin e drejtësisë kërkon rëndësinë e duhur, pasi është ndër kriteret bazë të komisionit evropian. Në këtë drejtim, ministri Halimi tha se, "opinionit i BE e cilëson reformën e rishpërndarjes së gjyqtareve, si një reformë të domosdoshme dhe nxit institucionet të përfundojnë sa më parë këtë reformë. Synimi ynë është që brenda muajit të fillojë riorganizimi i ri i gjykatave i cili do t'i japë një frymëmarrje të re sistemit gjyqësor dhe një fizionomi të re secilës gjykatë", theksoi Halimi.

Ministri i Drejtësisë vlerësoi reformat e kryera në bashkëpunim me EURALIS në sistemin e drejtësisë duke arritur të përmirësojë efikasitetin në gjyqësor duke

u udhëhequr nga standardet më të mira. "Reformat në drejtësi janë kryer me sukses. Kemi arritur të përmirësojmë efikasitetin në gjyqësor nëpërmjet marrjes së vendimeve shumë të rëndësishme, në bashkëpunim me misionin EURALIUS", theksoi Halimi.

Ai solli në vëmendje se është shënuar progres në reformimin e sistemit të drejtësisë, siç janë dixhitalizimi, reformimi i noterisë, reformimi i përmbartimit gjyqësor apo dhe çelja e portalit on-line për regjistrimin e pronave. "Kur flisim para një viti për planin tonë të jashtëzakonshëm për dixhitalizimin e drejtësisë, shumë ishin skeptike, madje ndonjë edhe na përqeshi. Por sot një vit më vonë, me të drejte krenohemi se kemi plotësuar, një nga një, dixhitalizimin e çdo sektori të drejtësisë. Kemi reformuar noterinë duke u bërë vend lider në rajon për sistemin elektronik të të dhënave mbi pasuritë, kemi ndërtuar portale on-line për regjistrimin e pronave, kemi reformuar përmbartimin gjyqësor dhe një sistem dixhital për menaxhimin e module të reja është në finalizim, kemi ndërtuar një sistem gjyqësor tërësisht dixhital, me seanca gjyqësore tërësisht

elektronike, me sistem audio dhe shume shpejt video, sistem tërësisht dixhital të përpunimit të dosjeve, portal on-line për gjyqtarë e qytetarë, duke e bërë realitet angazhimin tone. Fjalët kyçe që kanë përshkuar masat reformatore kanë qenë përgjegjshmëria, efikasiteti dhe lufta kundër korrupsionit përmes rritjes së transparencës", tha ai.

Ndërkaq, avancimin e reformave ministri i Drejtësisë e sheh edhe tek vullneti politik në parlament. Halimi i bëri thirrje Partisë Socialiste të japë konsensusin për miratimin e ligjeve me 3/5, kriteret këto të kërkuara nga BE-ja për marrjen e statusit të vendit kandidat. "Shqipëria është duke përjetuar momente të rëndësishme historike në drejtim të aspiratës të saj evropiane. Opinioni i bërë publik disa javë më parë nga Komisioni Evropian, është padyshim një vlerësim për reformat e ndërmarra gjatë këtyre viteve, por shërben edhe si një nxitje për të vijuar thellimin e tyre, në funksion të përafrimit të legjislacionit shqiptar me atë të vendeve më të përparuara të Bashkimit Evropian. BE kërkon miratimin e ligjeve me 3/5 dhe këto ligje ashtu si dhe ky që po prezantohet sot. Ato janë ligje që i ndihmojnë në konsolidimin e sistemit të drejtësisë. Ato ndihmojnë qytetarët, votuesit tanë në parlament, janë ligje që përmirësojnë jetën e tyre dhe që afrojnë Shqipërinë me standardet evropiane. Është e vërtetë që ky ligj nuk është në ato tre ligje që kërkohen të miratohen deri në 15 nëntor, por edhe ky ligj është i rëndësishëm. Reforma e drejtësisë është një proces i gjatë dhe i vështirë", deklaroi ministri i Drejtësisë Eduard Halimi.

Në Konferencën e organizuar për prezantimin e Projektligjit "Për Administratën Gjyqësore" ishin të pranishëm ministri i Drejtësisë Eduard Halimi, Drejtuesi i Misionit EURALIUS,

Joaquin Urias, shefi politik i Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri, Clive Rumbold, Kryetarë dhe Kancelarë të Gjykatave të Gjykatave të Rrethit dhe të Apelit, Anëtarë të Komisionit Parlamentar për Çështjet e Drejtësisë, Administrata Publike dhe Organizata të Drejtave të Njeriut si edhe të palë të interesuara në Sistemin Shqiptar të Drejtësisë si dhe eksperti për këtë çështje Joze De Lamata.

Projektligji i propozuar nga EURALIUS dhe

Ministria e Drejtësisë

Projektligji i propozuar adreson edhe gjetjet e Komisionit Evropian, sipas të cilit "mungesa e njëkuadrilijor gjithëpërfshirës për administratën gjyqësore në përputhje me standardet evropiane, me gjykata dhe staf gjyqësor të organizuar në mënyrë të qartë, pengon transparencën dhe efikasitetin në aktivitetet e gjykatave". Ai mban në konsideratë tipologjinë e organizimit të pushtetit gjyqësor, që për nga pikëpamja e organizimit, ku çdo gjykatë drejtohet me kompetenca të plota administrative nga Kryetari i Gjykatës.

Reforma e propozuar gjeti mbështetjen e drejtuesve të gjykatave. Gjatë analizës që kryetarët e gjykatave i bënë ndryshimeve ligjore të propozuara u vu re një mirëkuptim rreth modelit të ri mbi të cilën do tentohet të funksionojë administrata gjyqësore. Kjo reformë vjen pas shumë reformash të suksesshme që ministri Halimi ka kryer. Është ndërtuar një sistem dixhital, bazuar në transparencë; është reformuar noteria, përmbartimi, regjistrimi i pronave ndërsa brenda muajit nëntor do të bëhet rishpërndarjen e gjyqtareve.

Tema diskutimi, arrijtjet në sistemin e drejtësisë dhe situata e liberalizimit të vizave

Më 5 nëntor, mbledhet në Tiranë Ministeriali i ministrave të Brendshëm dhe Drejtësisë të Ballkanit Perëndimor

Në datat 5 dhe 6 Nëntor 2012, në hotel "Sheraton", Tiranë, me kujdesin e BE-së, nën Presidencën e Qipros, organizohet Ministeriali i radhës i ministrave të Brendshëm dhe Ministrave të Drejtësisë të Ballkanit Perëndimor. Temat e Ministerialit janë: Çështjet e procesit të Stabilizim-Asocimit për arrijtjet në sistemin e drejtësisë dhe të Ministrisë së Brendshme; Situata pas liberalizimit të vizave dhe lufta kundër trafikimit të armëve, qenieve njerëzore si dhe integrimi i romëve dhe të drejtat e tyre; Transparenca si mjet për luftën ndaj korrupsionit në sistemin e drejtësisë, bashkëpunimi gjyqësor për çështje penale dhe civile si dhe lufta kundër drogave. Çelja e dy sesioneve do zhvillohet në prani të mediave, ndërsa më pas vijohet me dyer të mbyllura dhe në përfundim të secilës nga të dy ditët, do të ketë konferenca të përbashkëta për shtyp.

Anëtarësimet/379 të rinj të rrethit Has, bëhen pjesë e FRPD-së

Në rrethin e Hasit i anëtarësuan 379 të rinj në Forumin Rinor të Partisë Demokratike. N/Kryetarja e FRPDSH, Greta Koçi mori pjesë

në prezantimin e tyre duke i uruar mirëseardhjen në gjirin e familjes më të madhe, Forumit Rinor të PD-së. Një javë më parë Greta

Koçi ishte në rrethin e Kuçovës ku prezantoi 346 të rinj. Koçi tha se i gjithë ky fluks anëtarësimesh të të rinjve në të gjithë Shqipërinë,

vjen si rezultat i besimit të krijuar ndaj punës dhe sukseseve të njëpasnjëshme të Qeverisë Berisha si: Liberalizimi i vizave,

anëtarësimi në NATO, Statusi kandidat në BE, infrastruktura rrugore, investimet në arsim, energjetikë etj..

Proza e autorëve françeskanë mes dy luftërave botërore

Nga Kastriot Marku

Kemi zgjedhur këtë prerje kohore, sepse ky është segmenti kohor ku e gjen më së shumti të realizuar vetveten kjo krijimtari letrare si e tillë. Qoftë periudha e para dy luftërave, qoftë ajo e pas tyre, kërkojnë një tjetër qasje vështrimore diktuar kjo jo vetëm si zhanër, por edhe si tematikë dhe për më tej si strukturë letrare. Pikërisht mbas lufte, kur brenda kufijve zyrtarë shtetërorë të shtetit shqiptar, për shkaqe që tashmë dihen e që nuk është vendi as koha që të merren këtu në shqyrtim, letërsia dhe autorët françeskanë u ekskomunikuan. Shkrimtari dhe kulturologu vijues i traditës së sivëllezërve të tij At Zef Pllumi do të shkruajë se "Kuvendi Françeskan u bënë pothuaj qendra më aktive e nacionalizmit shqiptar", ndaj ai bash për këtë dhe shumë arsye të tjera "...do të mbetet një fenomen i papërsëritshëm në historinë e kulturës shqiptare".

Në një konferencë të mbajtur në Romë më 8 maj 1953, letërsinë shqipe të gjysmës së parë të shekullit XX, Ernest Koliqi e ndante në dy ryma: në atë të tradicionalistëve dhe atë të modernistëve. Pjesa më e madhe e tradicionalistëve, nga të gjitha zonat e Shqipërisë, që mbledhur rreth dy revistave shkodrane *Hylli i Dritës dhe Leka*, do të thoshte ai. Në këtë pikëvështrim shkolla letrare françeskane e Shkodrës konsiderohet tradicionale sepse u mbështet në arrijtje më të mira të letërsisë së vjetër shqipe, përmes tematikës dhe motivimeve me konstruktive përmbajtësore e strukturore mbështetur mbi gegërishten letrare, në të cilën gërshetuan mendimin, psikologjinë popullore, filozofinë dhe simbolikën, idiomatikën e shprehjes, me përtëritjen dhe strukturimin e një teksti të ri letrar me elementë formalë gjuhësorë që orientohen drejt një qëndrimi estetik më të rafinuar.

Mbas prozës së Pjetër Budit dhe Pjetër Bogdanit dhe asaj të vijuese e dy të parëve sikurse ishte proza e Engjell Radojës, që pati njëfarë roli ndërmjetës me prozën e mëvonshme, Dom Ndoc Nikaj, Zef Mark Harapi patën një rëndësi vendimtare në shkrimin e këtij zhanri letrar. Por objekt i vështrimit tonë në një këndshikim më të ngushtë është proza e autorëve françeskanë, At Gjergj Fishtës, At Vinçenc Prennushit, At Bernardin Palajt, At Marin Sirdanit, At Justin Rotës, At Shtjefën Gjeçovit dhe posaçërisht At Anton Harapit. Themi posaçërisht për At Anton Harapin mbasi përkundrejt faktografisë së vërtetueshme historike, në anën tjetër edhe përkundrejt deklarimeve autoriale, proza e tij mbart të gjithë elementët e mjaftueshëm të shkrimit të pastër letrar. Nëse do të na duhet të bëjmë një lloj dallimi, veçimi për efekt njohjeje më të përhulluar, mund të themi se proza shqipe në gjysmën e parë të shekullit të XX, edhe pse pa ndonjë përvojë të gjatë kultivimi shkrimor, qoftë si tregues sasiash ashtu edhe cilësor, jo vetëm që u konstitua me statusin e saj të plotë si një krijimtari me vendin e saj të meritueshëm, por dha me dinjitet cilësorë më të mira estetike në të gjitha nivelet e komunikimit. Para së gjithash duhet të kemi



parasysh së në kontekstin kohor prej nga ku nis dhe përfundon objekti i vështrimit të kësaj kumtese, kulti i tekstit poetik kishte një lloj dominimi shpesh edhe të privilegjuar, që në anën tjetër dukej sikur e shpërfillte prozën. E njëjta gjë do të mund të thuhet edhe për dramaturgjinë, por nëse këtë të jezuitëve, grupi i dytë grupohet fizik sasiash, bazuar në numrin e veprave origjinale dramatike të botuara, e kemi fjalën për dramën, veçanërisht në Shkodër kjo sikur e tejkalonte këtë shpërfillje, e kjo falë komunikimit të teksteve dramatike në skene nëpër teatrot e shumtë, shfaqjet e njëpasnjëshme nga shoqëritë kulturore, të cilat kishin një jetë mjaft të gjallë dhe aktive në këtë qytet. Proza nga ana e saj erdhi me ngadalë, dhe si për të përplotësuar prozaizmin e saj të ripërkufizuar prej vetë termit, mori terrenin e saj pa shumë turr. Pjesa më e madhe e prozës konsumohej në trajtën e saj si shkrim publicistik socio-politik, e cila përcillte problematikën e kohës. Pa asnjë dyshim në terrenin aktivitetit kulturor dhe letrar të françeskanëve, detyrën më të rëndësishme e merr dhe e përcjell revista e mirënjohur e urdhërit *Hylli i Dritës*. Fakti se kjo e përkohshme themelohej bash në prag të përvjetorit të parë të Pavarësisë së vendit, në një gjendje të rënduar gjeopolitike në Ballkan dhe Evropë, veçanërisht për të ardhmen e shtetit shqiptar të sapokrijuar, dhe e gjitha kjo në prag të shpërthimit të Luftës së Parë Botërore, përbën edhe një lloj orientimi të përqëndruar në përcjelljen e ndjeshmërisë sociale dhe kulturore nacionale. Në këtë prerje tërthore zëri kryesor është pa mëdyshje ai i drejtorit dhe themeluesit të së përkohshmes At Gjergj Fishtës. Karakteri i drejtpërdrejtë i polemikës, komunikimi i hapur me të gjithë forcën e arsyes dhe të argumentit, dhe mbi të gjitha shfrytëzimi i të gjitha mjeteve të shqipes në një mënyrë krejt origjinale, bëri që kjo lloj publicistike të konsiderohej agresive, gjë që u bë shkak që revistës *Hylli i Dritës* t'i ndalohej botimi në vitin 1914 dhe në vitin 1924. Sikurse ka vënë re me të drejtë Ernest Koliqi, në vitet '30 në letërsinë shqipe vihet re dukshëm një lloj ndarjeje sa i

takon shkrimtarëve. Duket qartazi se kemi dy grupime të mëdha të krijuesve. Grupi i parë ishte ai tradicionalist ndërsa ai i dyti ishte ai i modernistëve. Nëse në grupin e parë janë shkrimtarët që grupohen rreth dy revistave shkodrane *Hylli i Dritës* dhe *Leka*, organe përkatësisht të françeskanëve dhe jezuitëve, grupi i dytë grupohet fillimisht tek *Illyria* e më pas tek *Shkëndija* pas të cilave qëndron Ernest Koliqi. Dom Ndoc Nikaj jo vetëm krijoi bazën, themelet e tejkalohej kulturore, Romanet e tij *Shkodra e rrethueshme*, (1913), *Fejesa n'djep a se Ulqini i marrun*, (1913), *Bukurusha*, (1918) dhe *Lulet në thes*, (1920), ndërtuar sipas mënyrës strukturore të romaneve klasike hapën ravën në të cilën do të ecte më vonë Zef Harapi, sidomos me romanin *Pushka e trahitarit*, botuar më 1921, me të cilin ka mjaft pika takimi si në planin tematiko-motivor, ashtu edhe në planin kompozicional. Ndërkohë proza e Ernest Koliqit shënoi një hop cilësor në prozën shqipe, jo vetëm duke thyer në një farë mënyre kultin e dominimit të vargut, por duke e vendosur prozën shqipe në rrjedhat moderne të letërsisë europiane. Koliqi duke rrëmuar në aspekte të jetës shqiptare, përgjithësisht me subjekte nga temat urbane, do ta zhbironte psikologjinë e individit shqiptar përmes një analize të brendshme të tipit freudist. Grupimi i parë ai i tradicionalistëve të *Hyllit të Dritës*, në rastin konkret françeskanët, ruajtën të njëjtën "hull" letrare, të cilën e kishin konturuar në poezi, por që e përplotësojnë në dramaturgji dhe respektivisht edhe në prozë. Sipas Koliqit "Mendësia letrare e redaktorëve të *Hyllit të Dritës* shquhej për papajtueshmëri kategorike ndaj cdo lloj parimi që nuk i bindej karakterit autokton, prijëve shpirtërore, të huaja për thelbin e vërtetë shqiptar dhe nevojës së tij elementare për konkretësi."

Parë në kontekstin e krijimtarisë së këtyre autorëve, sikurse e përmendëm më sipër autori më i veçantë shpërfaqet At Anton Harapi me dy romanet e tij, dhe si

për çudi të pabotuara në gjallje të autorit si botime me vete integrale dhe po ashtu të paemëtuara si të tilla përsa i përket zhanrit. Ato janë *Andrra e Prêtashit*. Kontribut për kulturën shqiptare. Urbanatit Antonio, Romë, 1959. IX-XLVI, 3-222f. (Vepër postume), sipas botimit të vitit 1959 në Romë. *Hylli i Dritës*, Tiranë, 1996. 222 f. *Valë mbi valë*, (vepër postume). Botue nën kujdesin e Atë Daniel Gjeçajt me bashkëpunim të Ana Lukës e Ardian Markut, Romë, 1995. 144 f. Në një lloj kuptimi këto vepra, bazuar në poetikën moderne të sugjeruar nga Umberto Ecco mund të shihen si vepra "të hapura", që sugjerojnë një mori leximesh, një seri ekzekutimesh sipas shijeve të secilit prej nesh që ushtrojmë leximin mbi to. Pothuajse njëzëri nga të gjithë studiuesit që janë marrë me këtë autor, kryevepra e tij është cilësuar *Andrra e Prêtashit*, e cila u botua së pari nën titullin: "Urti e burmi nder banorë të Cemtit. Ndolje historike rreth vjetit 1918-19" në vijim në 17 numra në revistën *Hylli i Dritës* në vitet 1933-1935, dhe më pas u botua si vepër postume nga françeskanët në mërgim vetëm në vitin 1959. Ajo ishte dërguar për botim në shtëpinë botuese "Vallecchi" në Firence me nismën e Institutit të Studimeve Shqiptare nën kujdesin e Ernest Koliqit, por për shkak të luftës nuk e pa dritën e botimit. Falë kujdesit të At Zef Valentinit, bocat u ruajtën dhe më pas iu kaluan Ernest Koliqit për tu realizuar përfundimisht nga sivëllai i Anton Harapit At Daniel Gjeçaj. Kjo vepër konsiderohet nga Plasari si kryevepër e Harapit, si vepër sui generis dhe autori i tij si i pakundshok në letërsinë shqipe ndërsa për një tjetër studiues ajo "përfaqëson një nga krijimet më origjinale të prozës shqipe". Që në fillim përballë studiuesve u shfaq çështja e klasifikimit se në cilin zhanër apo lloji letrare mund të vendosej kjo vepër, sepse ajo ishte një prozë në një gjendje të veçantë, leximi i së cilës të krijon përshtypjen se po lexon një ditur, kujtime autobiografike, kronikë historike, shënime etnografike apo etnopsikologjike, e që studiuesit Anton Nikë Berisha, Prend Buzhala, Bardhyl Matraxhiu, Bajram Olloni, Anton Gojçaj, me të drejtë e quajnë roman. Vepra e

ndarë në 22 kapituj, e konsideruar më së shumti si vepër antropologjike, "nuk i dha dorë kritikës si dhe lexuesit të kuptojnë dhe trajtojnë unitetin organik të një veprë të vetme letrare", sepse Harapi e kundron jetën shqiptare nga një këndvështrim sa filozofik, aq dhe historik, rrethuar plotësisht me një mjegullnajë letrare. "Andrra", fillon me një andërr dhe mbaron me një tjetër, duke u konceptuar mbi të si një lloj paralajmërimi i pritshëm, një lloj ankthi. Vepra tjetër e Harapit *Valë mbi valë*, edhe kjo e konsideruar si roman nga Robert Elsie dhe Tringë Dukagjini, u botua edhe ajo e plotë vetëm në vitin 1995. Kjo vepër ka për subjekt një udhëtim me take (varkë) të autorit nga Pazarit i Shkodrës, më pas përgjatë Liqenit të Shkodrës për në vendemërimin e tij si famullitar në fshatin Grudë, nën shoqërinë e dy peshkatarëve shirokas, Shanit e Gasprit. Ky udhëtim real, përgjatë bisedave dhe diskutimeve, përhumbet në refleksione befasuese filozofiko-jetësore, duke kërkuar kështu kuptimin e jetës. Në fakt bazuar në zhvillimet të ngjarjeve i bie që kronologjikisht *Valë mbi valë* të jetë fillimi i "fabulës" së dy romaneve, ngaqë ngjarjet nisnin me nisjen, lundrimin, kalimin e natës dhe mbërritjen, e që duke ndjekur kronologjinë e ngjarjes zgjasin nga ora 11 e paradites deri në mbrëmjen e vonë të ditës tjetër që i bie rreth një ditë e gjysmë, ndërkohë *Andrra* vjen më pas, por që zgjat disa muaj. Kështu nga dramatika e jetës së ashpër të malësorit tek *Andrra e Prêtashit*, tek *Valë mbi valë* kalohet tek kuptimësimi i përhulluar i vetë qenies në jetë. Harapi na shfaqet si një prozator mjaft i rafinuar, me një gjuhë të rrjedhshme, plot elegancë e shije, veçanërisht në përshkrim. Për të Ernest Koliqi do të shprehë: "At Anton Harapi bëri me perparue në shqipe trajtoft arsyetuese. I thellë në filozofi, psikolog depërtues, pa kurrnjë prijje kah poezija e shprehja e lulzuesme përgjithësisht, ai orvatej m'e mprehë stilin e vet si mjet bindës e si vegël vezhgimi. N'artikujt e shumtë botue në *Hyllin e Dritës*, nder prede qi mbante, nder mësim qe epte, shqipja hollohej për të shprehur shllime a idë të nalta e të thella. Natyrisht tue rrujtun njiherit pastrin e vet. Fijeve më t'imita t'arsyetimit Anton Harapi i a gjeti në gjuhë t'onë skajin shprehës. Letrarisht veptrat kryesore të tija janë *Andrra e Prêtashit* e *Valë mbi valë*. Në të dyja jeta shqiptare del e piksuesme me përpikni dhe vezhgueme me sy zhbirues. Me shprehje të thjeshta, portë sigurta, të rëndomta jo fluturuese, të kuptueshme jo të lulzueshme, Anton Harapi të bën me pa me sy dhe me prekë me dorë shka pershkrue edhe ta zbulon psihen e Shqiptarit me më të madhen qartësi. Vrejtitet e tija burojnë nga shikimi realist q ai hjedh mbi objektin. Nuk dalldiset kurr me mend. Nganjherë tregohet i thekun në shpirt. Mënyra e shkrimit e tij vjen tue shpalue me rend e kadalë, perçansuese, e shtrënguet për kah logjika, e pasun për kah mendimet, e shtruet dhe pa stërhollime për kah trajta me një

shqipe virgjin thjesht popullore." Të dy veprat nisnin si kallxime të ngjarjeve reale, por enden mirëfilli si vepra letrare, ngaqë elementi historik dhe ai i "trilluar" ropaten t'i zënë vendin një-tjetrit. Duken se janë vepra dokumentare të tipit memoareske, në të cilat autori, narratori dhe protagonist mendojnë të jenë i njëjti person: Atë Anton Harapi, i cili rrëfen në vetën e parë. Statusi tekstual i tyre ka ndryshuar në kohë, mbasi personazhet dhe ngjarjet reale të nëntëdhjetë e ca viteve më parë, nuk shfaqin interes sot për lexuesin dhe interesi për to sot është thjesht letrar, leximor. Në lidhje me sa thamë më sipër përsa i përket këtij statusi po sjellim për citim disa fragmente prej *Andrrës së Prêtashit*, duke nisur ngabotimi i saj i parë tek *Hylli i Dritës*. Duhet të theksojmë se një çështje tjetër e hapur është ajo sa i takon krahasimit të dy teksteve të botimit të veprës, atij të botuar fillimisht në *Hyllin e Dritës* në vitet 1933-1935 dhe botimit integral pas vdekjes së autorit rreth 25 vjet më pas në vitin 1959, një punë filologjike dhe tekstuale që pret të kryhet, mbasi teksti paraqet ndryshime jo të vogla, të cilat do të përbënin një punim tejet interesant për teknikën e shkrimtarisë së këtij autori. Të ndjekim Harapin. "Kur, në vjetin 1918-19, kjeçë famullitar në Grudë, pa qëllim botimi, vetëm për kujtim t'ernin privat, paçë ba do shenjime ndolljesh e përshtypjesh të jetës t'asajë kohë, n'at krahinë. Nji mik i emi m'u vu tepër t'i botoj, e un mbas dishiit të tij, i mora në dorë, u mundova me i dhanë nji unitet, e po i i shtypi nja disa kso kujtimesh, jo për letërsi as për histori, por vetëm që të mbahen mend, se banorët e Cemtit andej kufinit janë fjeshtë shqiptarë, e, të njafta me fise e bajrakë tjerë, kanë besën e burmin, doket e mentalitetin". "Që kur fillova fillova këto shenjime, paçë për qellim të tregoj jetën shqiptare, po ashtu të thjeshtë si zhvillohet e çfaqet ndër tana rrethanat në Hot e në Grudë. Për me e pru disi të plotsuem kvadrin e jetës s'atyne Shqiptarëvet, m'u desht me kallzue shum zakone e ndodhje, të cilat dën si të shmangen prej argumentit të parë qi është: andrra e Prêtashit e ropamet e atyne bajrakëvet për t'i a mbushë menden botës, se janë njimend Shqiptarë e duen të jenë edhe ata pjesë e Shqipnis. Lexuesi i ndershëm do të m'i falë këto kapërcime, i sigurtë se nuk janë as prolisitet as të shmangun n'argument, por plotsim i nji pjanit të bëm me qellim të caktuem". "Kështu, para 20 vjetëvevet u shkonte jeta në mjes të burravet të doksim. Këta pak rreshta të jesin dokument i përhershëm, për të tregue gjakun, shpirtin e doket fjeshtë shqiptare të banorëvevet të Cemtit, e të përhershme t'u a trashigojnë breznivet tona fisniknin e madhnin shpirtnore të Shqiptarit, burrë në vështrim të fjalës. Andrra e Prêtashit kishte pasë kenë profeci, të cilën e prita edhe e pash të vertetueme. Profeci Zo' kjoftë edhe andrra e Maxhit, të cilën, pastë kush mbas nesh e pã- të vertetueme!". "Për t'a plotsue kvadrin e jetës shqiptare, qi jam tue endë me këto shenjime, jo ndryshej, por njimend ashtu si vetë e pash e e provova, po u marr lëje

Fokus/Ndërrimi i udhëheqjes në Kinë

lexuesave t'u kallzoj vrasjen tragjike të një vajze së fejueme". "Un mbas një vjete kjeçë hjekë prej Grude, e kur në krye të disa vjetëve, më rã me shkue në Vukël, Frati disi gand, më kallxon, se po ishte n'atë famulli një farë Lene prej Grude; me interesë të madhe e pves, e vërtetoj se njimend po ishte Lenë Ujka."

Nëse ndiqen këto deklarime ambigue të autorit, secili veç e veç të shkëputura prej njëri-tjetrit, të krijuhet përshypja në fillim sikur janë të vërteta ato që thuhet, pastaj menjëherë pasi i ke hasur përgjatë leximit të gjitha njëpasnjëshëm, krijuhet dyshim se a thua në të vërtetë ai (Harapi) aq sa pohon po aq edhe mohon deklarimet e veta?! Ndonëse të përfshira brenda rëfimit herë si tekst herë si fusnotë, herë si hyrje e herë si mbyllje ato edhe pse në dukje jashtë rëfimit, janë pjesë e rëfimit, dhe kjo lloj dredhie, ky lloj kurthi, kjo lloj tymnaje e krijuar nga Harapi sikur e bën edhe më tërheqës tekstin e veprës për lexuesin e për më tepër statusin e saj. Po ashtu vendosja në tekstin e romanit të një dokumenti në dy gjuhë (shqip e frëngjisht), e memorandumit që malësorët ua drejtonin ministrave të Punëve të Jashtme të Uashingtonit, Londrës, Parisit e Romës, dokumenti i cili ishte botuar në gazetën *Posta e Shqypnis* me 23 nëntor 1918 në numrin 89, na sjell një tjetër dëshmi me interes mirfilli faktografik historik dhe dokumentar. Në fakt letërsia me tekstet e saj nuk e ka detyrim përputhshmërinë me të vërtetën historike, dhe as që gjykohej për këtë dhe as paraqesin interes për të. Ky kontekst nuk është një detyrim që përkufizon letërsinë apo kufijtë e saj. Por nëse teksti letrar përban një lëndë informuese të tillë, është akti i leximit që e përmbush funksionin e tekstit letrar si të tillë.

Marrëdhënia e narratorit me historinë. Në fillim të kapitullit XII, Harapi shkruan: "N'atë pakë kohë q ndeja famulliar në Grudë më rã m'u përshkue, të thuejsh, nepër tana valët e shtigjet e jetës shqiptare; paçë rasë t'a kundroj për s'afërmi çfaqen tipike të shpirtit t'atyne banorëve, mora pjesë të gjallë ndër gëzime e nder mjerime, me ta u këndova ndër kremte e dit hareje, e me ta dava vajin ndër gjamë e dit pikllimi; pësh urtën e tyne ndër pleqni, e u binda; u provova burmin, sa herë u rash për besë e falje, i gjeçë trima të qitun e burra të ndershëm, të zotët me vrã edhe me falë; mã se një herë më rã me i prekë në bujar, e pësh se kishin pse m'u mbajtë fisnikë: për besë e fë, për bukë e për mik, për nderë të vetit e të bajrakut, s'e bëshin mallë vehten as gjallninin e vet. Madhnija shpirtnore e tyne, njimend mbulue me atë mënyrë jete gati sit ë vrazhdë e trashamane, por vertë kapej nder ideale të nalta. Palci i jetës shqiptare m'u çfaq me tanë përmbajtjen e vet, e sa me gëzim lumnova për cilsit të mira, aq piklueshëm e me lot të zëmrës edhe dertova gabimet e të mbetat e Shqiptarit të maleve". Rëfimi i ngjarjes i vendosur në një kontekst të caktuar kohor, ku lexuesi duhet të kërkojë vijimin e ngjarjes/tekstit, e shtynjë këtë fundit të kërkojë të vërtetën në marrëdhënien shkak-pasojë. Kur lexon tekstin e romanit dhe ndeshesh me këto sa thamë më sipër, menjëherë lexuesi kujtohet se tashmë personazhet sigurojnë integritetin e tyre real në kohë dhe hapësirë falë unit autorial, autorit të veprës. Kjo "lojë" mes reales/dëshmisë dhe *fiction* gjen akord dhe dyshim njëherësh. Distanca mes narratorit/autorit, personazheve dhe lexuesit herë ngushtohet e herë zgjerohet në mënyrë sa të bukur aq edhe të dyshimtë, dhe kjo vjen kryesisht prej faktit se kjo vepër

me paratekstin e saj (shpjegimet, shënime në fusnotë) referimet kontekstuale autoriale, dokumentet etj), na paraqet një *sui generis* në letërsinë shqipe.

Lidhur me sa sipërthamë na lejohej të sjellim një lloj vlerësimi përgjithësues mbi prozën e autorëve françeskanë. Stili i Fishtës është i tejet i fortë, therës, përmblyës, turrës që të merr përpara, ndërkohë Vinçenc Prennushi në prozën e tij të butë, karakteristikë e prozaizmit ekleziastik, lëmon ritmin e frazëz me një njomësi shprehjesh të punuara kujdesshëm. Pothuajse e një trajtë të tillë të ngjashme është edhe proza e Bernardin Palajt dhe Justin Rrotës, e cila rrefen cilësisht saktësinë e vendosjes së strukturave gjuhësore tipike për gjermanishten ndikuar edhe nga stili i Carducciit sikurse ndodh me të parin, si dhe sintaksën mjeshtrorë, karakteristikë e përgatitjes gjuhësore të të dytës. Shtjefë Gjeçovi e Marin Sirdani duken disi më të thatë në stil me një lloj ngurtësimi që vjen prej vetë subjekteve dhe argumenteve të trajtuara sa kuvendare e aq etnologjike e historike, ndërkohë proza e Donat Kurtit na rrefen narratorin "popullor" që e merr për dorë lexuesin me shkriftësinë e gjuhës deri në shqimin e kuptimit më të pashkatërrueshëm. Njësitë rrefimorë të teksteve në prozë në krijimtarinë e autorëve françeskanë dëshmojnë dukshëm praninë e materies folklorike orale. Bash mbi trajta e gjedhe semantike traditore gojore këta autorë kanë mbindërtuar në shkrimin e kultivuar sosjen e kufijve të këtij oraltetit prej nga ku nis intertekstualiteti. Kjo gjë mund të shihet mjaft qartë tek kryevepra e Harapit *Andrra e Pretashit* si dhe ajo *Valë mbi valë* e të njëjtit autor, kjo e dyta jo më poshtë për nga vlerat estetiko-letrare. Kalimi nga diskursi oral si kulturë komunikimi bazuar mjaftueshëm në një të folur simbolike gati-gati të koduar që ishte privilegj i pleqve të urtë si burim përvojë, prodhon efekte të tilla edhe në rrefimin në prozë, qoftë si tematikë, qoftë si ndërtim gjuhësor. Leksiku, ndërtimet stilistike, shtrësëzimet semantike, ingranazhi tekstor në nivel të domethënies, njësitë rrefimorë si gjedhe ndërtimore mbivendosen mbi substratin gojor prej nga ku lind edhe efekti i leximit si kulturë receptive, çfarë kërkon një lloj rikualifikimi të domethënies kuptimore tekstuale. Polifonia e pandjeshme fillestare e tekstit, nuk të vendos aspak në dilemë, por të merr pas vetes menjëherë, duke prodhuar një ndjeshmërisë receptive sa provokative aq edhe lineare, të qartë e të njëtrajtshme e shpeshherë digresive përmes shkapërcimeve e rimirjeve të cilat më pas me një lexim të shtuar (të përqendruar), krijojnë një ndërlidhje interseante qoftë si karakter stilor, qoftë si konceptim strukturor që shpërfaq shumësi interpretative me domethënie parçiale në funksion të së tërës. Në përmblyje të kësaj trajtëse të shkurtër mund të konkludojmë se kësaj proze i ri për krye karakteristika esenciale e shkollës letrare françeskane, përdorimi i gjuhës së gjallë popullore, leksikut, frazeologjisë, lakonizmit dhe përdorimit ekonomik të gjuhës në nivel gati të paekjuivalent, falë përdorimit të fjalëve të urta, sentencave idiomatike kuvendore, përkundur përgjatë përvojave jetësore e të ruajtur me fanatizëm në kasafortën e kujtesës primitive me të gjithë kumtin dhe pajën psiko-sociale të lëmuar në kohë. Mbi këto përfundime mbështesim sugjerimin e kërkimit të shtuar mbi këtë temë e cila ofron edhe më tej qasje të interpretuese të përhulluara për të zbuluar ende vlera estetike që ka proza e autorëve françeskanë.

Më 8 nëntor në Pekin 2.200 delegatë mblidhen së bashku në kongresin e 18 të Partisë Komuniste të Kinës. Në fund të tij Kina do të ketë një udhëheqjes së re. Botës do t'i duhet të jetojë dhjetë vjet me të. Kur organizata më e madhe politike e botës me gati 80 milionë anëtarë mban kongresin e partisë, kjo është një ngjarje. Më shumë rëndësi merr një kongres i tillë partie, kur ai mblidhet një herë në çdo pesë vjet. Rëndësia globale politike e kongresit të 18-të të Partisë Komuniste të Kinës ushqehet nga fakti se kjo parti se bashku me gjithë shtetin e Kinës ka bërë pre edhe ekonominë e dytë më të madhe në botë, ka nën pushtetin e saj ushtrinë me personelin më të madh në botë, të pajisur me armë bërthamore dhe raketa ndërkontinentale dhe më e rëndësishmja është se udhëheqja e partisë do të ndërrohet dhe se bashku me të edhe ajo e shtetit. Organizimi i ndryshimeve në udhëheqjet e sistemeve autoritare është një manovër e vështirë politike. Komunistët e Kinës janë përpjekur ta lehtësojnë

këtë proces shpesh të dhunshëm dhe kaotik. Fjala kyçe këtu është «udhëheqja kolektive». Në krye të shtetit nuk do të jenë më figura udhëheqëse të tilla të mëdha si Mao Ce Dun, apo Deng Xiaoping, por një ekip teknokratësh. Ky do të përbëhet nga anëtarët e komitetit të përhershëm të Byrosë Politike. Aktualisht kjo qendër pushteti në Kinë përbëhet nga nëntë persona. Çdo dhjetë vjet lidhshipi i lartë zëvendësohet. Për këtë janë vendosur rregulla strikte për moshën. Kështu në kongresin e fundit të partisë në vitin 2007, në Komitetin Qendror janë përfshirë vetëm ato, të cilët kanë lindur pas vitit 1940. Në kongresin e 18-të, shtatë nga nëntë postet do të zihen nga persona të tjerë. Në teori statutet partiake të partisë komuniste e shohin përcaktimin e personelit drejtues si një proces, që kryhet nga poshtë lart. Më shumë se 2.200 delegatët e kongresit të partisë zgjedhin Komitetin Qendror me rreth 350 anëtarë. Komiteti Qendror nga ana tij zgjedh nga radhët e veta Byronë

Politike, të përbërë nga 25 anëtarë. Nga rradhët e saj vijnë nëntë politikanët e komitetit të përhershëm, nga të cilët njëri është sekretari i përgjithshëm i partisë. Pushteti i shtetit dhe i partisë janë një. Kështu sekretari i përgjithshëm është edhe presidenti i vendit. Kryeministri dhe kryetari i Parlamentit vijnë automatikisht nga komiteti i përhershëm i Byrosë Politike. Procesi i përzgjedhjes kryhet në fakt më shumë nga lart poshtë: Krerët e partisë zgjedhin anëtarët e komitetit qendror, partia miraton. Dhe kështu vazhdon. Komiteti qendror nga ana e tij konfirmon listën e kandidatëve për Byronë Politike dhe Komitetin e Përhershëm të saj.

Tregu i pushtetit/

Se kush bëhet anëtar në rrethin më të ngushtë të pushtetit, miratohet kohë më parë. Forcat kryesore në këtë luftë vendimtare janë pensiontët: Ish anëtarët e Byrosë Politike dhe politikanë në pension, të cilët veprojnë në sfond: Ish kryetari i shtetit dhe i partisë Jiang Zemin është për t'u përmendur këtu në

radhë të parë, por edhe ish kryeministri Li Peng. Kryetari aktual i shtetit dhe i partisë Hu Jintao dhe kryeministri i tij Wen Jiabao janë zgjedhur madje për postet e tyre të larta personalisht nga arkitekti i reformave Deng Xiaoping, që ndërroi jetë në vitin 1997. Një treg i rëndësishëm për balancimin e raporteve të pushtetit ndërmjet fraksioneve të ndryshme brenda Partisë Komuniste është vendi bregdetar Beidaihe në Detin e Kinës Lindore, dy orë larg nga Pekini me tren ekspres. Prapa dyerve të mbyllura në vilat e heshtura në verë u zhvillua një luftë e madhe për emërimin e ardhshëm të Byrosë Politike. Skandali politik rreth ish kryetarit të partisë së qytetit më të madh të Kinës e Chongqing, Bo Xilai, turbulloi planifikimin e sofistikut të personelit në krye të PKK. Se kush mban frerët e pushtetit krahas kryetarit të ardhshëm të shtetit dhe partisë Xi Jinping dhe kryeministrit të ardhshëm Li Keqiang, do të bëhet e qartë në fund të kongresit në konferencën përfundimtare për shtyp.

Ekonomia, si pjesë e shkencave sociale

Nga Ilda Mihali

Shkencat sociale u zhvilluan si fushë studimesh në shekullin e XIX-të. Kjo fushë lindi si nevojë e individit për të kuptuar aplikimet e teknologjisë së re dhe pasojat pozitive që solli kjo e fundit. Kjo shkencë jo vetëm që ndryshoi botën e të punuarit por transformoi mentalitetin e njeriut në raportin e tij me familjen, të tjerët por mbi të gjitha me punën. Kritika e saj na ndihmon të krijojmë përfytyrime për të ardhmen dhe për të kuptuar ç'po ndodh. Shkencat sociale ndihmojnë orientimin tonë për financat vetjake. Ekonomistët, por jo vetëm, psikologët, sociologët mundet gjithashtu t'na ndihmojnë të kuptojmë cilat janë vendimet optimale që duhet të ndërmarrim në një periudhë mirëqenieje dhe cilat janë ato që duhen në një periudhë krize. Njohuritë që kjo shkencë i ofron individit e vendos këtë të fundit në një terren që nuk është "aspak i minuar" për aq kohë sa nuk mungon mirinformimi. Njohuritë japin sigurinë e vendimmarrjes veçse nga personi përgjegjës pa ndërje nevojë për asistim nga dikush tjetër. Parë nga

një këndvështrim tjetër kjo shkencë kontribuon në mirëqenien tonë fizike. Nëse kemi orientim të duhur do bëjmë dhe zgjedhje të tilla. Nëse njohim raportet që ekzistojnë mes çmimit, cilësisë dhe konsumit padyshim që nuk do të dalim nga marketi me një faturë që mban një çmim të majmë por që në fakt nuk përkthehet nësoj në terma "produktesh të shëndetshme". Të kuptosh diçka ose pakçka nga shkencat sociale do të thotë të jesh një "person i socializuar" dmth: vendos lehtësisht dhe natyrshëm marrëdhënie korrekte me njerëzit, shmang çdo konflikt të mundshëm me to, krijon një ambient paqësor kudoqoftë: në punë, në komunitet me komshinj, në shkollë... Përtej këtyre, shkencat sociale reflektojnë intelektualitet publik. Kjo shkencë ka si detyrë ta bëjë gjithçka më interesante: të shohim një program në tv jo vetëm se s'kemi ç'bëjmë tjetër por me qëllimin për të përfutur diçka, të ndjekim një film jo vetëm për të përshpejtuar procesin e gjumit por për të parë përtej një realiteti që është ky i yni dhe mbi të gjitha për ta çuar imagjinatën në kufijtë ku mendja s'ka shkuar


kurrë më parë. Përtej të gjithave kjo shkencë merr një vlerë të veçantë dhe padyshim të rëndësishme sepse bën më të mirën për fëmijët. Prindërit gjithnjë e më tepër shqetësohen që fëmijët tyre të kenë në duar programe edukimi të cilat më tepër sesa i bëjnë fëmijët akademikë të shkëlqyer i bëjnë këta të fundit në fakt që t'i marrin me dëshirë në duar programet mësimore. Ka përpjekje të vazhdueshme që këto programe të jenë gjithnjë e më tepër për nga niveli i interesit sa më pranë shijëve të të rinjve, pra çdo informacion që duhet të merret kjo shkencë e përcjon në formën më të mirë për ta bërë sa më interesante. Kjo disiplinë mund ta ndryshojë veçse për mirë procesin e globalizimit. Bota bëhet një vend më i mirë kur njerëzit njohin dinjitetin dhe shijojnë të gjitha të drejtat e tyre. Në mënyrën më direkte shkencat sociale influencojnë programet për të drejtat e njeriut, programet për mbrojtjen e fëmijëve të braktisur, për mbrojtjen e grave të dhunuara apo divorcuara dhe pa mbështetje ekonomike dhe çdo program që ka në thelb njeriun dhe të drejtat

parësore të tij. Për njerëzit të cilët duan të gjejnë format më të mira, duke qenë dhe racionalë në kohë, për të zgjeruar horizontin e tyre të njohurive mjafton të kenë në duar produktet fizike të kësaj shkence që janë librat dhe nëpërmjet tyre mund të gjenden të gjitha format për të shijuar ndryshe një libër, për të shijuar ndryshe një udhëtim, për të përjetuar ndryshe një ndjenjë dhe për të parë ndryshe botën. Në krye të të gjithë argumenteve për të mirat që kjo shkencë i sjell njerëzimit qëndron: "Shkencat sociale garantojnë demokracinë tonë". Ato ofrojnë të gjitha perspektivat për shoqërinë, për ta mirinformuar atë por jo vetëm, edhe për ta ndihmuar ketë të fundit të përfitojë nga mirinformimi për të marrë vendimet më të mira, për të njohur përgjegjësitë por mbi të gjitha për të kërkuar dhe mbrojtur të drejtat. Për elitën e cila analizon dhe bën kritikë për të shpjeguar çdo fenomen dhe ngjarje ekonomike (beteja në fakt për të cilën bëhen të gjitha luftërat), kjo fushë shndërrohet në katalizatorin që i jep impulse të shpejta zgjidhjes dhe argumentimit të çdo problemi.

Shtëpia Botuese "55"

Botimet e reja

"Kryeministrat dhe ministrat e shtetit shqiptar në 100 vjet"



Libri: "Kryeministrat dhe ministrat e shtetit shqiptar në 100 vjet", 273 faqe me ilustrime.

Autori: Kastriot Dervishi
Shtëpia Botuese "55",
Tiranë

"Kryeministrat dhe ministrat e shtetit shqiptar në 100 vjet" është një fjalor enciklopedik i veçantë që tregon të dhënat kryesore të 467 personave që kanë qenë kryeministra dhe anëtarë të Këshillit të Ministrave të shtetit shqiptar në këto 100 vite. Botimi me ilustrime është i pari i këtij lloji në Shqipëri. Libri është i ndarë në disa kapituj. Në fillim jepen të gjitha kabinetet shqiptare dhe një përmbledhje e programeve dhe historikut të tyre sipas epokave. Jepen jetëshkrimet me foto të personave që kanë qenë anëtarë të Këshillit të Ministrave, ndërsa statistika të tjera tregojnë të dhëna mbi ministrat. Një vend i posaçëm i është lënë fotografive ku kanë qenë selitë të Këshillit të Ministrave si dhe ministrive kryesore.

Botimet e reja

Përfaqësuesi special i BE-së në Prishtinë

Zhbogar: Duhet zhvilluar tre lloje të dialogut



Qëndrimi i Komisionit Evropian se Serbia duhet të respektojë integritetin territorial të Kosovës, nuk do të thotë se Serbia duhet të pranojë pavarësinë e Kosovës, ka thënë përfaqësuesi special i BE-së në Prishtinë, Samuel Zbogar. "Kjo do të thotë se jemi kundër ndarjes së Kosovës dhe se nuk do të mbështesim idetë për ndarje", ka deklaruar Zbogar. Ai po ashtu

ka theksuar nevojën e zhvillimit të tre llojeve të dialogut: njëri ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit për normalizimin e marrëdhënieve, tjetri në mes të autoriteteve kosovare dhe qytetarëve të veriut dhe i treti në mes të serbëve në veri dhe atyre në jug të Ibrit. Diplomatat evropiane kanë kushtëzuar Serbinë me normalizimin e marrëdhënieve me

Kosovën, si kusht për të shënuar hapa para drejt BE-së. Në një raport të publikuar muajin e kaluar nga Komisioni Evropian, thuhej se Serbia duhet të respektojë integritetin territorial të Kosovës. Raporti kanxitur reagimin e zyrtarëve serbë, të cilët kanë thënë se një gjë e tillë nënkupton njohje të Kosovës dhe se ata nuk mund ta pranojnë.



Pacolli takon në Londër përfaqësues të Indonezisë dhe Egjiptit-u kërkon njohjen e Kosovës

Në kuadër të angazhimeve shtetërore për sjelljen e njohjeve të reja, zëvendëskryeministri i Qeverisë së Kosovës, Behxhet Pacolli ka takuar në Londër përfaqësues të lartë të Indonezisë dhe Egjiptit, thuhet në një komunikatë për opinion nga zyra e tij. "Gjatë takimeve të ndara me përfaqësues të dy vendeve është dakorduar për intensifikimin e kontakteve, të cilat do të krijojnë kushtet e nevojshme për fillimin e marrëdhënieve ndërshtetërore me Republikën e Kosovës. Në këtë kontekst, zëvendëskryeministri Pacolli ka informuar përfaqësuesit e këtyre dy vendeve që shumë shpejtë do të zhvillojë vizita në Xhakartë dhe Kajro për të qar përpara procesin e njohjes së Republikës së Kosovës", përfundon njoftimi.



Kosova, e gatshme të hapë zyrën ndërlidhëse në Beograd

►Udhëheqësit e Kosovës dhe ata të Serbisë mund të arrijnë marrëveshje më

7 nëntor, për hapjen e zyrave ndërlidhëse respektivisht në Prishtinë dhe Beograd

Qeveria e Kosovës shprehet e gatshme të hapë zyrën e saj ndërlidhëse në Beograd, si dhe t'i mundësojë Serbisë që edhe ajo të hapë zyrën e saj në Prishtinë. Ky zotim i Qeverisë së Kosovës, është shprehur të premten publikisht nga zëvendëskryeministri Hajredin Kuçi. Në kuadër të disa temave që Përfaqësuesja e Lartë e Bashkimit Evropian për Politikë të Jashtme, Katherinë Ashton, i ka paraparë për agjendën e takimeve ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit, hapja e zyrave ndërlidhëse mendohet të jetë një nga hapat e parë. Kryeministri Hashim Thaçi ka konfirmuar se shumë shpejt, sipas paralajmërimeve të mërkurën më 7 nëntor, do të pasojë edhe takimi tjetër me kreun e Qeverisë së Serbisë dhe për këtë qëllim, ai tha se tashmë ka konsensus të brendshëm politik dhe mbështetje ndërkombëtare. "Kosova ka ndërtuar një konsensus të gjerë politik dhe qytetarë për këtë proces, duke kuptuar apo duke u përpjekur për t'i kuptuar drejt edhe refuzuesit e këtij

procesi", ka deklaruar Thaçi. Ndërkohë, duke elaboruar temat e takimeve, por edhe parimet bazë që Prishtina mendon t'i ndjek në procesin e bisedimeve me Serbinë, zëvendëskryeministri Hajredin Kuçi, mes tjerash, ka bërë publike edhe gatishmërinë e Kosovës për hapjen e zyrave ndërlidhëse me Serbinë. Ndonëse jo në nivel të ambasadave dhe pa simbole shtetërore, këto zyra shihen si hapi i parë drejt një procesi të gjatë të relaksimit të raporteve ndërmjet dy vendeve. "Qeveria e Kosovës është e gatshme t'i kryej obligimet për hapjen e zyrës në Beograd. E dini që në Kosovë ka ambasada dhe zyre ndërlidhëse, besoj se e njëjta do të ndodhë edhe në raportin Kosovë - Serbi. Me siguri se është një hap drejt normalizimit të marrëdhënieve mes dy vendeve, por njohja do të jetë me një akt formal në mes dy qeverive dhe kjo duhet të ndodhë që të arrihet traktati i paqes", ka thënë Kuçi. Në anëntjetër, deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Skënder Hyseni, ish-ministër

i Jashtëm i Kosovës, ka thënë se zyra ndërlidhëse ka pasur edhe UNMIK-u në Beograd, në kohën kur Kosova nuk ka qenë shtet. Andaj ai nuk sheh edhe shumë përfitime, por as dëme nga një veprim i tillë. Hyseni ka thënë se e parasheh si shumë të vështirë fillimin e punës dhe funksionimin e zyrës së Kosovës në Beograd marrë parasysh atmosferën jomiqësore që ekziston atje në raport me Kosovën dhe shtetësinë e saj. "Unë mendoj që një zyre e Kosovës, kudo që të vendoset në Beograd, nuk do ta ketë të lehtë në fillim, për shkak të një disponimi shumë armiqësor që kanë edhe qytetarët individualisht aty këtu, por sidoqoftë nuk duhet t'i mbyllem sytë para kësaj", ka theksuar Hyseni. Një mendim krejtësisht tjetër në raport me bisedimet me Serbinë dhe rezultatet nga ky dialog ka shprehur Lëvizja Vetëvendosje. Deputeti i kësaj partie politike, Visar Ymeri ka thënë se Kosova nuk ka kurrfarë dobie nga hapja e kësaj zyre. "Është vetëm

një tentim që të arrihet një marrëveshje për diçka që mund t'ju duket qytetarëve si diçka progresive, e në anën tjetër të shfrytëzohet pastaj për negociatat në mënyrë që të fillohet me tema të vështira tjera, ku Kosova do të humbë shumë e që do të jenë të përqendruara për veriun dhe një status autonom për këtë pjesë", është shprehur Ymeri. Nisur nga historia dhe përvoja e bisedimeve me Serbinë, ish-ministri i Jashtëm, Skënder Hyseni, është shprehur me shumë rezerva nëse pritet nga ky proces mund të jenë ato që synohen të arrihen në bazë të agjendës që tashmë është prezantuar para opinionit. Megjithatë, ai ka thënë se beson që palët duhet të negociojnë dhe të insistojnë në normalizimin e raporteve ndër fqinjësore. "Nëse e shikoni atë histori dialogu mes dy entiteteve dikur, dhe tash dy shteteve të pavarura e sovraane, ka qenë prore një histori e dështimit, e përpjekjeve të pasuksesshme për arritjen

e ndonjë marrëveshjeje të pëlqyeshme për të dyja palët. Ky fakt të bën të ndihesh jo shumë optimist, por kjo nuk duhet assesit të shndërrohet në pengesë të pakalueshme, e sidomos nuk guxon të shndërrohet në pengesë të vet dialogut", ka thënë Hyseni. Dialogu Prishtinë-Beograd, sipas agjendës së prezantuar nga Qeveria e Kosovës, mes tjerash kërkon zbatimin në e të gjitha marrëveshjeve të arritura dyja vendeve, hapjen e zyrave ndërlidhëse, angazhimin e palëve për zbardhjen e fatit të personave të zhdukur të luftës, pastaj anëtarësimin e papenguar të Kosovës në nisim dhe forume ndërkombëtare e deri te mbrojtja e trashëgimisë kulturore e fetare serbe në Kosovë. Po ashtu, në këtë dialog është përmendur çështja e zhbërjes dhe largimit nga Kosova të strukturave paralele të financuara nga Serbia, temë kjo që më pas besohet se mund të nisë edhe pjesën më të vështirë të këtij dialogu, atë të trajtimit të çështjes së pjesës veriore të banuar me shumicë serbe.



Dačić thotë se nuk ka të bëjë me përgjimet e zyrtarëve të lartë në Serbi

Kryeministri i Serbisë, Ivica Dačić, i cili është njëkohësisht edhe ministër i Punëve të Brendshme, tha se raportimet për përgjimet e paligjshme ndaj presidentit dhe zëvendës kryeministrit të Serbisë janë të papranueshme. Në një prononcim televiziv gjatë ditës së sotme, Dačić shtoi se ai personalisht nuk kishte të bënte asgjë me këtë rast. Ai gjithashtu tha se policia e vendit ka nevojë për reforma urgjente dhe se të gjithë zyrtarët e përfshirë në përgjimin ilegal do të zëvendësohen në një të ardhme të afërt. Më herë gjatë ditës, mediat serbe transmetuan një deklaratë të zëvendës kryeministrit, Aleksandar Vučić, ku ai akuzonte policinë se ilegalisht e ka përgjuar atë dhe zyrtarë të tjerë të lartë, përfshirë presidentin Tomislav Nikolić.



Tavo- Likurenzos: Thellim të bashkëpunimit në shëndetësi mes Shqipërisë dhe Greqisë

Shqipëria dhe Greqia do të thellojnë bashkëpunimin në sektorë të ndryshëm në fushën e shëndetësisë, ndër të cilat dhe farmaceutika edhe menaxhimi spitalor. Ministri i Shëndetësisë, Vangjel Tavo, po zhvillon vizitë zyrtare në Greqi, gjatë së cilës është takuar me homologun grek Andreas Likurenzos. Gjatë takimit, bashkëbiseduesit ranë dakort për vijimin e bashkëpunimit në shëndetësi. Ministri grek Likurenzos vuri theksin tek zbatimin e marrëveshjes aktuale. Likurenzos

veçoi në këtë drejtim trajnime dhe shkëmbime eksperiencash për stafin mjekësor shqiptar dhe grek. Lidhur me bashkëpunimin dypalësh, ministri Tavo u shpreh lidhur me gjetjen e fushave me interes të përbashkët në këtë sektor jetik. Palët në takim u dakorduan lidhur me pika të ndryshme të bashkëpunimit dypalësh sikurse trajnime dhe shkëmbime eksperiencash për mjeket, por dhe asistencë në ndërhyrje të ndryshme, me interes reciprok. Po kështu, gjatë takimit u theksua

Lidhur me bashkëpunimin dypalësh, ministri Tavo u shpreh lidhur me gjetjen e fushave me interes të përbashkët në këtë sektor jetik. Palët në takim u dakorduan lidhur me pika të ndryshme të bashkëpunimit dypalësh

thellimi i bashkëpunimit në dy fusha të rëndësishme të shëndetësisë, në farmaceutikë dhe menaxhim spitalor, një nga drejtimet kryesore të reformës në shëndetësi.

Rruga e re është e asfaltuar dhe ka një gjerësi asfalti prej 4.5 metra

Falë financimit të FSHZH 5 mijë banorë të komunës Vig – Mnel në Shkodër lidhen me rrugë të asfaltuar

Gjendja e rrugës ekzistuese ka qenë shumë e keqe, duke u bërë pengesë serioze për transportin normal të njerëzve dhe mallrave. Rruga ka qenë pjesërisht me zhavorr, pa vepra arti, dhe e pakalueshme për mjetet e vogla

Segmenti rrugor Ura Gjadër - Mnel 7.2 km e gjatë, është një tjetër investim i Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe lidh 3 fshatrat e komunës jo vetëm me njëra tjetrën por dhe me rrugën Lezhë - Vau i Dejës, një tjetër investim i FSHZH në këtë rajon. Kjo rrugë është financuar nga Qeveria Shqiptare dhe Banka Islamike për Zhvillim (IDB). Gjendja e rrugës ekzistuese ka qenë shumë e keqe, duke u bërë pengesë serioze për transportin normal të njerëzve dhe mallrave. Rruga ka qenë pjesërisht me zhavorr, pa vepra arti, dhe e pakalueshme për mjetet e vogla. Gjatë stinës së shirave rruga bllokohej nga reshjet dhe rrëshqitjet e skarpave. Përpara rikonstruksionit, rruga qenë vetëm me një kalim. Rruga e re është e asfaltuar dhe ka një gjerësi asfalti prej 4.5 m, përfshirë bankinë anësore nga njëra anë dhe nga ana tjetër kanal betoni dhe kuletë që ka bërë të mundur sistemimin e ujërave sipër-

faqësore. Ajo është e pajisur me të gjithë elementet e nevojshëm të infrastrukturës, siç janë sinjalistika vertikale dhe horizontale, tombino, mure mbajtës etj. Në zonat e banuara rruga është e pajisur me trotuare për kalimin e këmbësorëve. Në qendrën e komunës është bërë i mundur sistemimi asfaltimi i sheshit ku gjenden shkolla, qendra shëndetësore, zyrat e komunës, kisha e fshatit dhe objekte të tjera të rëndësishme. Drejtori Ekzekutiv i Fondit Shqiptar të Zhvillimit z. Benet Beci, gjatë ndjekjes së punimeve në fazën përmbyllëse të tyre, në bashkëbisedim me gazetarët e pranishëm ndër të tjera tha se: - "Segmenti rrugor që po shohim sot lidh me rrugë të asfaltuar 3 fshatra me qendrën e komunës Vig - Mnel dhe rrugën Lezhë - Vau i Dejës. Ai është e vetmja rrugë lidhëse për 5 mijë banorët e fshatrave të kësaj komunë. Me përfundimin e këtij segmenti rrugor, banorët e kësaj zone do të qarkullojnë në kushte normale transporti,

duke lehtësuar lidhjen me shërbimet arsimore, shëndetësore, dhe tregjet. Ky investim, plotëson më së miri nevojat e kësaj komunë për infrastrukturë rrugore. Afërsia me rrugën nacionale Lezhë - Shkodër, u krijon mundësi banorëve të zonës të lidhen me Shkodrën dhe Lezhën, duke diversifikuar kështu mundësitë e lidhjeve ekonomike dhe tregtare. Punësimi dhe rritja e aksesit në tregun e punës janë një përfitim real i banorëve të kësaj zone. Një fakt tjetër që dëshmon suksesin e këtij investimi është tendenca e rikthimit të banorëve të ikur këtu 20 vjet. Rikthimi i tyre do të rivitalizojë jetën sociale dhe aktivitetin ekonomik të zonës". Fermerët e kësaj zone janë të njohur për prodhimet bujqësore dhe blegtorale, në mënyrë të veçantë për vreshtarinë dhe ullirin. Infrastruktura rrugore e përmirësuar po jep rezultate të prekshme për komunitetin e kësaj zone, duke nxitur zhvillimin e bujqësisë dhe duke ofruar mundësi



reale për një zhvillim social - ekonomik të qëndrueshëm. Ajo sjell lehtësi të mëdha për transportin e prodhimeve drejt tregut të Lezhës dhe Shkodrës. Nga ana tjetër rikonstruksioni i kësaj rruge do të bëjë të

mundur zhvillimin e turizmit dhe zbulimin e trashëgimisë kulturore të kësaj zone. Kishat e vjetra dhe kalaja 400 vjeçare që tashmë janë lehtësisht të arritshme falë ndërtimit të kësaj rruge.

Hoxha: Aboneja me apo pa karton është njësoj e vlefshme

Bashkia e Tiranës: Masa deri heqje licence, për operatorët që krijojnë shqetësime tek qytetarët

Bashkia e Tiranës ka reaguar dje, lidhur me shqetësimet që disa operatorë të transportit urban u kanë krijuar qytetarëve që dispononin abone të pashoqëruar me karton. Drejtoresha e Transportit dhe Lëvizshmërisë në Bashkinë e Tiranës, Nereida Hoxha ka theksuar se të gjithë abonët me apo pa karton janë të vlefshme në të gjithë linjat e transportit, brenda Bashkisë së Tiranës.

Znj. Hoxha ka paralajmëruar masa, deri në heqjen e licencës, për të gjithë operatorët që krijojnë shqetësime tek qytetarët. "Bashkia e Tiranës dëshiron t'i bëjë me dije të gjithë qytetarëve, se të gjithë abonët e shitura me apo pa karton shoqëruar, janë të vlefshme për të udhëtuar në të gjithë linjat e transportit qytetas,

brenda bashkisë së Tiranës. Në rast të çdo shqetësimi të krijuar ndaj qytetarëve që udhëtojnë me këto abone, Bashkia e Tiranës do të ndërmarrë të gjithë masat administrative, në përputhje me kontratat e nënshkruara me këta operatorë, duke shkuar deri në ndërprerje të licencës. Bashkia kërkon të informojë të gjithë qytetarët, që abonët e emetuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve janë në përputhje me legjislacionin, të pajisura me elementë sigurie, siç është shiriti i ndritshëm dhe shkrimi "Bashkia e Tiranës". U bëj thirrje përsëri të gjithë operatorëve, që të mos krijojnë asnjë shqetësim për qytetarët që janë të pajisur me bileta të pajtimit mujor, me apo pa kartonin shoqëruar"



Bashkia kërkon të informojë të gjithë qytetarët, që abonët e emetuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve janë në përputhje me legjislacionin, të pajisura me elementë sigurie, siç është shiriti i ndritshëm dhe shkrimi "Bashkia e Tiranës"

► Kryetare e Shoqatës së Veshjeve, Lindita Legisi

“Heqja e TVSH-së për makineritë do të rrisë investimet”

Heqja e tatimit të vlerës së shtuar (TVSH) për importimin e makinerive në industrinë me fason do të mundësojë rritje të investimeve dhe rinovim të teknologjisë.

Kryetare e Shoqatës së Veshjeve, Lindita Legisi, u shpreh se niveli i investimeve që bën çdo ndërmarrje në vit për makineri dhe pajisje është sa 15 % e investimit fillestar.

Sektori i industrisë me fason po ndjen gjithnjë e më shumë efektet e krizës ekonomike që po kalojnë vendet e Eurozonë, shprehet Legisi, duke shtuar se tashmë po syno-

het të zgjerojnë gjeografinë e këtij biznesi drejt tregjeve arabe.

Industria me fason njohu një zhvillim të madh gjatë viteve të fundit, kjo ndikuar dhe nga krahu

i lirë i punës. Aktualisht në vendin tonë zhvillojnë aktivitetin e tyre ekonomik mbi 400 ndërmarrje, ku janë punësuar rreth 100 mijë persona.



Zbutje varfërie dhe punësim përmes ngritjes së bizneseve sociale në të gjithë vendin

Iniciativa e Qeverisë shqiptare prezantohet në Universitete ku shpallet konkursi për idetë më të mira

Zgjidhja e qëndrueshme e problemeve sociale si varfëria e papunësia, nëpërmjet ngritjes së bizneseve sociale në të gjithë vendin, që do të sigurojnë të ardhura të mjaftueshme për të nxjerrë grupe dhe individë në nevojë nga hendeku i varfërisë ishte në qendër të Konferencës “Lëvizja Gjithëpërfshirëse e Biznesit Social në Shqipëri – Ide që krijojnë impakt” organizuar në Universitetin “Luigj Gurakuqi” në Shkodër. Gjatë Konferencës u promovua lëvizja më e re e iniciuar nga Qeveria shqiptare dhe u promovua çelja e konkursit të ideve për ngritjen e bizneseve sociale, ku idetë më të mira do të përzgjidhen për t'u mbështetur nga Shoqëria “Nxitja e Biznesit Social në Shqipëri” dhe Biznesi Social Yunus, organizatorët e aktivitetit. Përfaqësues të Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, të Biznesit Social Yunus, Shoqërisë “Nxitja e Biznesit Social”, pedagogë dhe studentë të Universitetit, autoritetet lokale të Shkodrës, shoqërisë civile dhe bizneset, pjesëmarrës në Konferencë ndanë mendimin se zbatimi i politikave dhe programeve aktive të mbështetjes për individët dhe grupet në nevojë u jep zgjidhje të qëndrueshme problematikës së tyre, duke i nxjerrë përfundimisht nga hendeku i varfërisë dhe duke i integruar në shoqëri, kundrejt politikave pasive të mbështetjes të vazhdueshme me pagesa kesh nga programet ndryshme të mbrojtjes sociale.

Bizneset sociale janë biznese të cilat si qëllim kryesor të ekzistencës së tyre nuk kanë maksimizimin e fitimit, por zgjidhjen e një problemi social si papunësia, varfëria, integrimi i kategorive vulnerabël, etj., vënë në dukje organizatorët e Konferencës. Prefekta e Shkodrës, znj. Voltana Adema, vuri në dukje se “të gjithë kemi përgjegjësi sociale për-



derisa jetojmë në shoqëri dhe është detyrë si e institucioneve ashtu edhe e shoqërisë civile të mendojë dhe punojë për të integruar individët dhe grupet në nevojë në jetën social-ekonomike të vendit. Shkodra është një zonë në të cilën iniciativat sociale për mbështetjen e grupeve në nevojë nuk kanë qenë të pakta, ndaj edhe besojmë se lëvizja e biznesit social do të përqafohet dhe se shumë shpejt do të bizneset e para sociale do të ngrihen në këtë zonë”. Dekania e Fakultetit Ekonomik, Prof.Dr.Arieta Troshani, siguroi se Universiteti do të jetë mbështetës i çdo iniciative që ka impakt ekonomik në rajonin e Shkodrës. Për Drejtoreshën e Shoqërisë “Lëvizja e Biznesit Social në Shqipëri”, znj.Ardita Bonatti, “një nga fokuset kryesore të Lëvizjes është bashkëpunimi me universitetet dhe të rinjtë për promovimin dhe realizimin e këtij program, pasi janë pikërisht të rinjtë që mund të gjenerojnë ide inovative”. Sipas Drejtorit të Yunus, Bi-

znosi Social në Shqipëri, z.Shkëlzen Marku, “bizneset sociale janë ngritur dhe funksionojnë jo vetëm në vende të varfëra, por veçanërisht në vende të zhvilluara si Angli, Francë, Gjermani, Japoni, etj., ku kanë njohur shtrirje të gjerë dhe kanë pasur impakt të madh në zgjidhjen e qëndrueshme të çështjes të cilën janë fokusuar”. Lëvizja e Biznesit Social në Shqipëri dhe Biznesi Social Yunus synojnë ngritjen e një inkubatori orientimi, këshillimi dhe rrjetizimi mes bizneseve sociale si dhe krijimin e një fondi që do bazohet në donacionet e donatorëve të ndryshëm dhe investuesve filantropikë. Ka qenë iniciativa e Kryeministrit Berisha për të sjellë përvojën më të mirë Botërore në luftën ndaj varfërisë dhe papunësisë, duke kontaktuar me nobelistin Prof.Muhamed Yunus dhe kërkuar prej tij bashkëpunim me Qeverinë shqiptare për të zbatuar Lëvizjen gjithëpërfshirëse të Biznesit Social në Shqipëri.



Qëllimi është që të rriten të ardhurat e familjeve të varfra të zonave malore

Malet drejt tregut, projekti i ri që nxit prodhimet Bio “Made In Albania”

9.2 milionë usd është fondi që po disburson prej fillimit të këtij viti Agjencia e Zhvillimit të Zonave Malore IFAD, për zbatimin e projektit “Malet drejt Tregut” me qëllim rritjen e prodhimeve bujqësore BIO

9.2 milionë usd është fondi që po disburson prej fillimit të këtij viti Agjencia e Zhvillimit të Zonave Malore IFAD, për zbatimin e projektit “Malet drejt Tregut” me qëllim rritjen e prodhimeve bujqësore BIO, “Made in Albania”. Burime nga IFAD bënë të ditur se projekti që përfshin kryesisht zonat e Shkodrës, Lezhës, Kukësit dhe Dibërës parashikon krijimin e një Qendre Ndërkombëtare për Produktin e Pastër në Shqipëri, duke synuar një përqasje praktike efektive për zgjidhjen e problemeve të ndotjes dhe trajtimit të mbetjeve si dhe për përdorimin jo efektiv të burimeve natyrore nga industritë dhe organizatat tjera. Projekti shprehen ekspertët e fushës, po punon në drejtim të zhvillimit të tregjeve rurale (komponent që konsiston në promovimin e tregjeve rurale, zbatimin e investimeve strategjike për ngritjen e tregjeve dhe mbrojtjen e mjedisit rural). Se dyti në ngritjen e strukturës prodhues –treg dhe menaxhimi i programit që synon të sigurojë përgjegjësi implementimi dhe kapacitete për zbatimin e dy komponentëve të mësipërm teknik. Puna e IFAD-it në Shqipëri fokusohet kryesisht në zhvillimin e zonave malore. Qëllimi i tij është që të rrisë të ardhurat e familjeve të varfra të zonave malore. Programi ka si objektiv reduktimin e varfërisë rurale me përmirësimin e oportuniteteve të të varfëve ruralë për pjesëmarrjen dhe punësimin në zinxhirët e furnizimit rural konkurrues dhe komercial përmes aksesit të rritur në tregjet, njohurive teknike dhe financës.

Shtëpia Botuese "55"

Botimet e reja

ATATURKU

RILINDJA E NJË KOMBI



«Shtëpia Botuese 55», ka hedhur në treg një nga biografite më të mira të shkruara për Ataturkun nga historiani anglez Patrick Kinross

«Ataturku nuk ishte një turk i zakonshëm. Kishte lëkurë shumë më të çelët nga bashkëkombësit e tij, me mollëza të kërcyera dhe sy blu të mëdhenj. Ishte truppakët dhe i matur në lëvizje. Rrezatonte energji, madje edhe kur ishte në prehje; sytë e ftohtë i shndrisnin me gjallëri të pazakontë dhe përçonin dritën e gjëndjeve të tija kontradiktore. I dhënë pas pamjes së tij të jashtme, vishej në mënyrë të stërholluar, lakonte vetullat në mënyrë të vetëdijshme, krenohej për gjymtyrët e tij të mirëformuara....Në klimën e ndryshimit që pasoi vdekjen dhe pasimin e tij në pushtet nga konvencionali Inonu, një admiruese e Ataturkut tha: "Turqia ka humbur dashnorin e saj dhe më në fund duhet të mbledhë mendjen të gjejë një bashkëshort"

Botimet e reja


Shtëpia Botuese "55"

Botimet e reja

Rexhep Tajjip

ERDOGAN

Lindja e një lideri



Hüseyin Besli
Ömer Özbay

Rexhep Tajjip
ERDOGAN
Lindja e një lideri

55
Shtëpia
Botuese

«Shtëpia Botuese 55» ka hedhur në treg biografinë e kryeministrit turk Rexhep Tajjip Erdogan

«Të gjithë kanë nga një histori, pa dyshim. Por disa njerëz kanë me mijëra... Rexhep Tajjip Erdogan është njëri prej këtyre. Ndoshta ai është më në krye të atyre që gjenden në qendër të vëmendjes shoqërore. Nga vetë emri, ai është kryeministri. Ai na sheh të gjithë ne, por ne e shohim më shumë atë. Me dashuri apo urrejtje, me admirim apo zemërim, me shpresë apo me frikë, të gjithë e ndjekim me vëmendje. Rexhep Tajjip Erdogan është subjekt i aktualitetit të Turqisë prej vitesh. Ndaj ky libër flet për historinë e një vendi, e një njeriu dhe të së "tashmes", shkruajnë autorët e këtij libri Hüseyin Besli – Ömer Özbay

60-vjet veterinar, Tafaj: Rritje të cilësisë së diplomave për tregun evropian

Ministri i Arsimit, Myqerem Tafaj, në ceremoninë e 60-vjetorit të krijimit të Fakultetit të Veterinarisë, kërkoi rritjen e cilësisë së diplomave. Fakulteti të Veterinarisë, pjesë e Universitetit Bujqësor të Tiranës, i vetmi universitet të cilit i njihet diploma edhe jashtë vendit. Tafaj i kërkoi diploma më të mira, me qëllim që studentët t'u përshtaten edhe parametrave të tregut evropian. "Na duhet shumë punë për të arritur standardet e cilësisë që janë të krahasueshme me

ato evropiane. Ne jemi të vetëdijshëm që sot pedagogët përballohen me një ngarkesë të madhe mësimore dhe kanë një kohë të kufizuar për kërkimin shkencor. Jemi të vetëdijshëm që dhe infrastruktura laboratorike për kërkime në këtë fushë është ende jo plotësisht e mjaftueshme", tha ministri. Në këtë përvojtor të këtij fakulteti ishte i pranishëm ministri i Bujqësisë, Genc Ruli, ministri i Jashtëm, Edmond Panariti, si një ish-student dhe pedagog i këtij institucioni të lartë arsimor, si dhe ambasadori italian në Tiranë, Massimo Gaiani.



Korçë, universiteti "Fan Noli": Kushte bashkëkohore për akomodimin e studentëve

Në Universitetin e Elbasanit mbahet Konferenca Ndërkombëtare "Zhvillimi i Arsimit dhe Edukimit në Shekullin e XXI"

Universiteti "Fan Noli" në qytetin e Korçës këtë vit akademik ka ofruar kushte të favorshme dhe me standarde për akomodimin e studentët konviktorë, në fjetoret e qytezës student, me 750 shtretër, salla studimi, shlodhjeje dhe argëtimi. Nga 7500 studentë që ka ky universitet, 400 prej tyre janë akomoduar në fjetoret e qytezës Studenti tek shëtitorja "Rilindja", ndërsa shumë të tjerë janë vendosur në banesa me qira. Studentët konviktorë janë kryesisht nga skajet e largëta të qarkut juglindor, si edhe nga rrethet e ndryshme të vendit. Risi, këtë vit akademik, sipas Rektorit të këtij universiteti, Gjergji Mero, është rritja e numrit të studentëve nga komuniteti rom. "Tre vjet më parë kishim nga ky komunitet vetëm një student në Fakultetin Ekonomik, ndërsa këtë vit janë 23 studentë romë, që ndjekin studimet në të katër fakultetet e Universitetit të Korçës dhe numri i tyre në të ardhmen do të jetë edhe më i madh, sepse i madh është edhe numri i nxënësve nga ky komunitet në shkollat e arsimit parauniversitar të Korçës", thotë Mero. Ndërkohë Akademikë të universiteteve të Romës, Gjermanisë, Durrësit, Tiranës, Gjirokastrës, drejtues të lartë të Ministrisë së Arsimit, etj, diskutuan të premtën në Konferencën Ndërkombëtare "Zhvillimi i Arsimit dhe Edukimit në Shekullin e XXI", organizuar nga fakulteti i Shkencave të Edukimit, në Universitetin "Aleksandër Xhuvani", në Elbasan, mbi përvojën dhe zbatimin e parimeve të vendosura nga ministrat e vendeve anëtare të KE-së për Arsimin e Lartë dhe zbatimin e tyre në Universitetin "Aleksandër Xhuvani", në këtë qytet. Dekani i fakultetit të Shkencave të Edukimit, Vilson Kuri, siguroi të pranishmit se institucioni që ai drejton do të zgjerojë në të ardhmen fushën e tij të veprimtari si trajnimi teknik profesional, rritjen dhe funksionimin në fakultet të qendrave shkencore. Sipas



dekanit Kuri, kjo kumtesë sjell përvojën se si po zbatohet në këtë fakultet një nga parimet e shprehura nga ministrat e

Arsimit të 47 vendeve anëtare të Këshillit të Europës, të cilët kanë theksuar kompetencën në qytetari si një nga pesë

Kukës, subvencionimi i librit shkollorë përfitojnë 75 % e nxënësve

Mbi 75 për qind e nxënësve të arsimit parauniversitar në qarkun e Kukësit përfitojnë nga vendimi i Qeverisë për subvencionimin e librit shkollor si pasojë e nivelit të varfërisë. Drejtori i drejtorisë Rajonale të Arsimit në qarkun verilindor, Ylli Metaliaj, pohon se pas dokumentacionit të grumbulluar, 75 për qind e nxënësve të shkollave 9- vjeçare dhe të mesme, në këtë vit mësimor do të subvencionohen për librin shkollor. Krahasuar me një vit më parë, numri i nxënësve që përfitojnë nga ky vendim ka një rritje të ndjeshme,

duke bërë që fatura financiare, e cila kalon vlerën e 2.4 milionë lekëve, t'i kalojë Drejtorisë Rajonale të Arsimit. Për këtë vit shkollor, në rrethin e Kukësit numërohen 42 shkolla 9-vjeçare dhe 9 shkolla të arsimit të mesëm, ndërsa numri i nxënësve arrin në arsimin 9-vjeçar 9500 dhe në arsimin e mesëm 2400. Në rrethin e Hasit funksionojnë 20 shkolla 9-vjeçare dhe 2 shkolla të mesme, ndërsa numri i përgjithshëm i nxënësve është 3500 në arsimin 9 vjeçar dhe 1100 në arsimin e mesëm.

kompetencat për promovim të kulturës demokratike dhe kohezionit social. Zv/ministrja e Arsimit, Nora Malaj, vlerësoi reformat e Qeverisë gjatë këtyre viteve të fundit në arsimin universitar dhe atë profesional. "Kjo konferencë përbën qasjen më të rëndësishme të arsimit në shekullin XXI. Aktualisht ne kemi 160 mijë studentë në të gjitha nivelet Master e Doktoraturë. Kemi arritur që të ulim nivelin e braktisjes së shkollës, sot jemi në nivelin e 0.5 për qind të braktisjes së shkollës, kjo falë kontributit tuaj, se si keni orientuar drejt kurrikulat mësimore për të nxjerrë një sistem arsimor dhe një radhë mësuesish të cilët kanë rritur nivelin e cilësisë", tha Malaj. Ndërsa

Rektori i Universitetit të Elbasanit, Liman Varoshi, bëri të ditur se në fazën përgatitore të buxhetit, në këto vite i kemi kushtuar një vëmendje të posaçme veprimtarive kërkimore, duke i konceptuar këto aktivitete si pjesë integrale të procesit mësimor. "Procesi kërkimor do të jetë pjesë e pandarë e të gjithë zhvillimeve universitare, në mënyrë që pedagogu të jetë edhe një hulumtues", tha Varoshi. Ai tha se me projekte të veçanta do të mbështetet procesi mësimor, ku do të integrohet gjithë trupa mësimore, përfshirë edhe studentët, që është edhe një risi për Universitetin e Elbasanit.

Drejtoresha e BB për Shqipërinë: Kemi pasur marrëdhënie të shkëlqyer me qeverinë

► Jemi shumë të kënaqur me partneritetin tonë këtu dhe me kënaqësi presim të punojmë edhe për shumë vjet të tjera në Shqipëri, edhe pse vendi juaj është duke ecur drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Vendi juaj është një vend me të ardhura të mesme, mirëpo ne besojmë se ka shumë fusha ku ne mund të mësojmë nga përvoja e Shqipërisë dhe ku ne mund të sjellim përvojën botërore në vendin tuaj

Ilda Mihali

Jane Armitage, Drejtoreshë e Bankës Botërore për Shqipërinë dhe Koordinatore Rajonale për Evropën Juglindore në konferencën e saj për mediat në Tiranë tha se: - "Mendoj, siç e thashë edhe në kremtimin e njëzetvjetorit të partneritetit, kemi pasur një marrëdhënie të shkëlqyer dhe të afërt këtu në Shqipëri. Kemi një zyrë lokale të shkëlqyer dhe shpresoj se me stafin tonë këtu njiheni dhe komunikoni rregullisht me ta për t'u informuar. Jemi shumë të kënaqur me partneritetin tonë këtu dhe me kënaqësi presim të punojmë edhe për shumë vjet të tjera në Shqipëri, edhe pse vendi juaj është duke ecur drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Vendi juaj është një vend me të ardhura të mesme, mirëpo ne besojmë se ka shumë fusha ku ne mund të mësojmë nga përvoja e Shqipërisë dhe ku ne mund të

sjellim përvojën botërore në vendin tuaj. Pra, marrëdhënia jonë nuk ka të bëjë vetëm me dhënie e huave e të kredive, paçka se edhe kjo ka rëndësinë e vet, por marrëdhënia jonë ka të bëjë edhe me punën analitike, këshillimin, rritjen e kapaciteteve, si edhe me ndarjen e njohurive. Përvojat e Shteteve të reja Anëtare të Bashkimit Evropian, sidomos Kroacia që ndodhet në prag të anëtarësimit të saj në BE, por edhe përvojat e Rumanisë dhe Bullgarisë janë me vlerë. Këto janë përvoja nga të cilat shpresojmë të mësojmë, në mënyrë që të ta ndihmojmë Shqipërinë në rrugën e saj drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian". Ndërkohë pyetjes se a ka ndonjë paketë ndihme për Ballkanin Perëndimor, duke përfshirë edhe Shqipërinë, në mënyrë që këto vende të mund t'i bëjnë ballë ndikimit të krizës së vendeve të Eurozonës, Armitage



ju përgjigj se: "Pranohet gjerësisht se rajoni i Ballkanit Perëndimor është prekur veçanërisht negativisht nga situata në Eurozonë. Në Azinë lindore e në Amerikën Latine po shohim një rimëkëmbje, ndërsa në Ballkanin Perëndimor dhe në Evropën Qendrore e Lindore

ndihet ende ndikimi shumë negativ dhe ekziston nevoja të Komisioni Evropian, FMN-ja, Banka Botërore, BERZH-it, BEI dhe donatorët dypalësh të rrisin mbështetjen e tyre. Dhe po planifikojmë ta bëjmë këtë gjë, në të gjithë Ballkanin Perëndimor, si edhe këtu në Shqipëri, për të ofruar më

shumë mbështetje financiare dhe për ta lidhur atë me reforma të rëndësishme, konsolidimin fiskal dhe reformat strukturore për t'i ndihmuar këto vende t'i bëjnë ballë kësaj situatë shumë të vështirë".

Inaugurohet salla e intervistimit të të miturve ne Policinë e Vlorës

Ambasadorja e Francës vlerëson punën e policisë në luftën kundër trafikut të qenieve njerëzore

Në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Vlorë, gjatë ditës së sotme, datë 02.11.2012, është zhvilluar ceremonia e inaugurimit të Sallës për intervistimin e të miturve, e cila është mundësuar falë mbështetjes së Ambasadës Franceze. Në këtë ceremoni ishin të pranishëm Ambasadorja Franceze, Zj. Christine Moro, Zv/Ministri i Brendshëm, Z. Arben Ristani, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit Z. Hysni Burgaj, Drejtori i Policisë së Qarkut Vlorë, Z. Artan Cuku, si dhe drejtues e punonjës të tjerë të kësaj drejtorie. Në fjalën e saj gjatë kësaj ceremonie Ambasadorja e Francës Zj. Christine Moro, duke evidentuar projektet e bashkëpunimit me Policinë e Shtetit dhe Ministrinë e Brendshme evidentoi dhe progresin e bërë nga Policia e Shtetit në luftën kundër trafikut të qenieve njerëzore. "Shqipëria ka bërë progres të konsiderueshëm në fushën e luftës kundër trafikut të qenieve njerëzore. Ne bashkëpunojmë ngushtë dhe rregullisht me autoritetet dhe shërbimin e policisë shqiptare sa i përket këtyre problematikave dhe

profesionalizmi e niveli i performancës është në përmirësim të vazhdueshëm. Lufta kundër trafikut të qenieve njerëzore mbetet një prioritet. Për këtë arsye Franca është e kënaqur që vë në dispozicion të policisë shqiptare këto salla intervistimi, të cilat i përgjigjen standardeve europiane, dhe që do ta ndihmojnë të rrisë edhe më tej rezultatet në luftën kundër trafikut të qenieve njerëzore dhe në të njëjtën kohë, në luftën e saj kundër

krimit të organizuar, një aspekt i të cilës është trafiku i qenieve njerëzore. Ngritja e vënies në funksionim e ambienteve për intervistimin e të miturve tregon njëkohësisht vullnetin e Francës për të bashkëpunuar me Shqipërinë në fushën e mbrojtjes së të miturve. Të miturit janë në të njëjtën kohë e ardhmja e vendit dhe qenie vunerabël. Qofshin viktima apo fajtor të shkeljeve të ligjit, ata kanë të drejtën e një trajtimi të veçantë që merr në konsideratë vunerabilitetin e

tyre, vuajtjet e tyre prej fëmije. Të intervistuarit kërkojnë pajisje të veçanta, teknika të veçanta dhe ky është objekti i bashkëpunimit tonë." - u shpreh Zj. Moro. Po ashtu Zj. Moro evidentoi nivelin e lartë të bashkëpunimit mes Ambasadës së Francës dhe Ministrisë së Brendshme e Policisë së Shtetit, si dhe garanto autoritetet e pranishme se: - "në përmbytjen e objektivave që janë vendosur në kuadër të implementimit të standardeve

europiane dhe prioriteteve të axhendës europiane të Shqipërisë, ju mund të keni besim në bashkëpunimin dhe mbështetjen e Francës. "Ndërkohë Zv/Ministri i Brendshëm, Z. Arben Ristani, duke u ndaluar në trajtimin e veçantë që duhet t'u bëhet të miturve nga strukturat e Policisë së Shtetit theksoi: "Gjatë ushtrimit të detyrës, sidomos kur bëhet fjalë për të miturit të përfshirë si autorë krimesh apo objekt në krim, strukturat e Policisë së Shtetit duhet të veprojnë me përkushtim dhe profesionalizëm, i cili duhet të karakterizojë ato, me qëllim garantimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. "Në përfundim të ceremonisë të pranishmit vizituan ambientet e brendshme të sallës së intervistimit të të miturve. Kjo është salla e dytë specifike për intervistimin e të miturve viktima të trafikut të qenieve njerëzore dhe abuzimit seksual, e ngritur me mbështetjen e Ambasadës Franceze, pas asaj të Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tiranë, inauguruar rreth 1 vit më parë.

Ndryshime në polici, ja shefat e rinj në Tiranë

Ndryshime në Polici. Emrat e rinj të firmosur nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë, Hysni Burgaj emërohen në krye të Komisarivateve dhe disa drejtorive në Tiranë, Durrës e Kavajë. Në krye të Qarkullimit Rrugor në qytetin e Tiranës vjen, Genci Peka, ndërsa në krye të Komisarariatit të Kavajës vjen Urim Rexhepi. Ndryshimet prekën dhe komisarariatet e Tiranës, ku emrat e rinj që vijnë në krye të tyre janë: Nazmi Shuli emërohet shef i Komisarariatit 1, Dritan Dorda emërohet shef i Komisarariatit 2, Afred Njuman emërohet shef i Komisarariatit 3 vjen (ishte shef komisarati në Mirdite), Gazmend Hamitaj emërohet shef i Komisarariatit 4 (ish-shef i komanduar i komisarariatit nr1) Rakip Hoxha emërohet shef i Komisarariatit 5, Sejfulla Metko emërohet shef i Komisarariatit 6. (ka qene shef komisarati ne Durrës, dhe ne Elbasan etj). Largohet nga komisarati nr 6, Dritan Lame emërohet në një pozicion drejtues brenda strukturës së drejtorisë së përgjithshme të policisë së shtetit. Lulëzim Shala, largohet nga shef komisarati nr 4, duke u emëruar në një komisarariat e drejtorisë së policisë, Berat. Ali Allaraj, le detyrën e shefit të Qarkullimit Tiranë dhe merr një pozicion drejtues në Policinë e Tiranës. Ndryshimet janë në kuadër të strukturës së re të Policisë së Shtetit, projekt i përgatitur në muajin Janar dhe i cili do implementohet brenda datës 1, dhjetor 2013. Ndryshim ka pasur dhe në shefat e komisarivateve në Durrës, Shijak dhe Krujë.


SHSSH: Rriten pagesat për personat me aftësi të kufizuara

Shërbimi Social Shtetëror njofton se në zbatim të ligjit të ri për ndihmën dhe shërbimet shoqërore dhe implementimit të Planit të Veprimit të Strategjisë kombëtare për personat me aftësi të kufizuara (PAK) në fund të vitit 2005 dhe më pas, janë zbatuar disa politika të reja, të cilat kanë krijuar mundësi për lehtësimin e kushteve të jetesës për personat me aftësi të kufizuara. Sipas të dhënave të SHSSH, bazuar në udhëzimet e fundit të miratuara nga MPCSSHB, pagesat për grupet përfituese të PAK janë rritur dhe efektet financiare të pagesave kanë filluar nga data 01.09.2012. Konkretisht, SHSSH sqaron se në Shtator të vitit 2012 masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar u rrit në 9500 lekë në muaj, po ashtu dhe 9500 lekë për kujdestarët. Gjithashtu në fund të Shtatorit 2012 masa e përfitimit për personat e verbër dhe kujdestarët e tyre u rrit në 10850 lekë në muaj. Ndërkaq masa e përfitimit të personave para e tetaplegjik u rrit në 9500 lekë në muaj dhe 10000 lekë për kujdestarët e tyre. Mbështetja me fonde për personat me aftësi të kufizuara, ishte 7.1 miliard lekë në vitin 2006 ose rreth 16 % më shumë se në vitin 2005, në vitin 2007 fondi ishte 8.2 miliard lekë ose 15% më shumë, për vitin 2009 fondi ishte 10.2 miliard lekë, për vitin 2010 fondi ishte 11.7 miliard lekë, për vitin 2011 ky fond ishte 12.236 miliard lekë dhe për vitin 2012 janë programuar 12.859 miliard lekë. Në fund të vitit 2011 u trajtuan me pagesa dhe shërbime rreth 143.547 PAK mendore, fizikë, të verbër, para e tetaplegjikë dhe invalidë pune apo 3.6% e popullsisë së vendit, nga rreth 93 mijë që ishin në vitin 2005. Me ligjin nr. 9355 dt. 10.03.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore" dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, u zgjeruan kufijtë e përfitimit të PAK. Të gjithë personat me aftësi të kufizuara, pavarësisht nga moshë dhe shkaku i dëmtimit, përfitojnë një pagesë për aftësinë e tyre të kufizuar. U hoq kufiri i moshës deri në 21 vjeç, për përfitimin e pagesës së aftësisë së kufizuar. Kjo pagesë në vitin 2006, u rrit nga 6800 lekë në muaj në 8000 lekë në muaj. Për vitin 2008, pagesa u rrit në 8700 lekë në muaj ose 28% më shumë se në vitin 2006 dhe për vitin 2011 kjo pagesë u rrit në 9300 lekë në muaj. PAK, që sipas vendimit të Komisionit Mjekësor të Aktësisë për Punë (KMCA), kanë nevojë për shërbimin e një kujdestari, përfitojnë një kujdestar me pagesë, edhe në rastet kur familjanuk është në shtëpi dhe ndihmës ekonomike. Nga kjo masë kanë përfituar rreth 10 mijë PAK shtesë. Pagesa e kujdestarisë në vitin 2006 u rrit nga 6800 lekë në muaj në 8000 lekë në muaj. Ndërsa në vitin 2011, kjo pagesë shkoi në 9800 lekë ose 3000 leke më shumë se në vitin 2006. Personat e verbër si dhe kujdestarët e tyre që nga Gushti i vitit 2011 përfitojnë një pagesë prej 10600 lekësh në muaj.

Nga Kastriot DERVISHI


Internimet e vitit 1954

“Internim për simpati ndaj regjimeve të kaluara”



Kolegjiumi i Ministrisë së Punëve të Brendshme, mbledhje duke diskutuar masat e marra për internimin, dëbimin apo konfiskimin e pasurisë së personit të procedurës. Në fund të diskutimit merrej një vendim, i cili pavarësisht se nuk kishte kaluar në Komisionin e Internimeve – Dëbimeve dhe Konfiskimeve, hynte në fuqi menjëherë. Më pas komisioni në fjalë merri vendimin sipas dispozitave të ligjit 649, datë 10.1.1949 të internimeve.

Kur bëhej fjalë për dëbim, duhet kuptuar një masë e përhershme e zhvendosje së qytetarit nga vendbanimi i parë në vendbanimin e ri që ishte kryesisht fshat dhe punë e rëndë e ofruar në rastin më të mirë. Dëbimi nuk përsëritej si masë, pra ishte përfundimtare. Ndërsa internimi jepej me masë 5 vjeçare. Mund të përsëritej një ose dy herë të tjera, por jo më shumë. Regjimi e kishte gjetur zgjidhjen që në rast të përsëritjeve, e kthente internimin në dëbim dhe e mbyllte këtë punë. Në këto listime, nuk shënoheshin fëmijët nën 14 vjeç. Nga kjo praktikë masa e të internuarve ulej. Përfundimisht nëse kemi një shifër mbi numrin e të internuarve në Shqipëri, kjo është 2 – 3 herë më e lartë po të kemi parasysh fëmijët e paregjistruar të internuar, të lindurit në internim, si dhe personat e dëbuar të cilët nuk quheshin më të internuarit. Por një shifër tjetër është edhe ajo e të dëbuarve me vendim të komisionit vendor të internimeve që funksiononte pranë komiteteve ekzekutive të këshillave popullore të rretheve. Ky komision që kryesohej nga kryetari i komitetit, mbi bazën e propozimeve të ardhura nga dega e punëve të brendshme të rrethit, bënte internim – dëbimin brenda rrethit nga njëra njësi vendore te tjetra. Me të tilla vendime janë zhvendosur një pjesë e madhe e popullsisë së cilësuar e padëshirueshme. Në fund të vitit 1953 u mbyllën kampet tela me gjemba dhe në fillim të vitit 1954 u praktikuan





kampet e hapura, por me kufizim të lëvizjes. Procedurat e internimit ishin të njëjllota në përpilimin dhe motivimin e internimit.

Detyrë e Sigurimit të Shtetit ishte dhe përpilimi i listave të personave që përbënin rrezikshmëri shoqërore për shkaqe politike apo jopolitike, duke ia propozuar më pas organit vendimmarrës. Kjo buronte edhe nga platforma operative e organeve të MPB-së, e cila u pasua edhe nga miratimi i bazës ligjore për internimet.

Familjet që internoheshin, kur ktheheshin nga internimi, nuk gjenin më në shtëpitë e tyre mallin që kishin lënë më parë. Banditizmi ishte i hapur. Nuk ishte vetëm vuajtja në vendet e internimit.

Në bazë të ligjit nr.649, datë 10 Janar 1949 u krijua komisioni i internimeve, dëbimeve dhe konfiskimeve të pasurisë pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme. Komisioni i drejtuar nga ministri, me anëtarë oficerë të lartë të MPB-së, mbledhje zakonisht një herë në muaj dhe

sipas nevojës edhe më shumë, duke shqyrtuar dhe miratuar propozimet që vinin nga degët e punëve të brendshme të qarqeve me miratimin e sekretarit të parë të njësisë më të madhe vendore (rrethi apo qarku). Në vendimet e këtyre viteve, mungojnë internimet për motive jopolitike. Vendet e vuajtjes së dënimit janë akoma kampet e rrethuar me tela me gjemba, duke i bërë internimet gati burgje të hapura. Ata që ishin larguar nga Shqipëria, kishin krijuar argumentin e parë për komunistët se ishin



kriminelë lufte. Për këtë arsye, familjarët e tyre u larguan nga qytetet, u internuan dhe pronat iu morën menjëherë nëpërmjet shtetëzimit. Kjo "teknikë" vazhdoi më tej me identifikimin e çdo kundërshtari politik të mbetur në Shqipëri. Nëse ishte me bindje të ndryshme, p.sh. ballist apo zogist, mund të shkoje në burg së paku për 20 vjet ose mund të pushkatoheshe.

Pasi u kalua edhe ky proces, u vërejt se kishte një kategori që gjoja kishte përfituar nga rrogat e të mira të afërta me to para luftës. Kësaj edhe administrata e Mbretit Zog, u vu përpara përgjegjësisë se kishte marrë më shumë rroga nga ç'i takonte se kishte siguruar shtëpi të mira, etj. Edhe kjo kaloi në një proces zhvendosjeje.

Regjimi jo pak herë vinte në skenë filma apo tallej si se të zotët e shtëpisë, nxirreshin jashtë saj apo përfundonin në rastin më të mirë në bodrum, e në shtëpitë e tyre të ndërtruara me aq sakrificë, futeshin njerëzit e markës "o me dele o me kapele".

Në këtë mënyrë filloi të ndërtohej nga pikëpamja socialo-politike, qyteti shqiptar. Ky fenomen ishte më i dukshëm në Tiranë.

Më 2 gusht 1954 Presidiumi i Kuvendit Popullor, nxori

Regjimi e kishte gjetur zgjidhjen që në rast të përsëritjeve, e kthente internimin në dëbim dhe e mbyllte këtë punë. Në këto listime, nuk shënoheshin fëmijët nën 14 vjeç. Nga kjo praktikë masa e të internuarve ulej. Përfundimisht nëse kemi një shifër mbi numrin e të internuarve në Shqipëri, kjo është 2 – 3 herë më e lartë po të kemi parasysh fëmijët e paregjistruar të internuar, të lindurit në internim, si dhe personat e dëbuar të cilët nuk quheshin më të internuarit. Por një shifër tjetër është edhe ajo e të dëbuarve me vendim të komisionit vendor të internimeve që funksiononte pranë komiteteve ekzekutive të këshillave popullore të rretheve.

dekretin nr.1906 "internimin e dëbimin si masë administrative", i cili bën një rregullim të dekretit të vitit 1949 pa sjellë ndryshime thelbësore. Tashmë komisioni nuk merrej me konfiskimet, ndërsa vazhdonte të ekzistonte pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Pas vitit 1960, komisioni u zhvendos në selinë e Kryeministrisë dhe drejtohej nga zëvendëskryeministri i parë me zëvendës, ministrin e Punëve të Brendshme. Që nga ky vit, e deri kur u mbyll komisioni, më 1990, ishin gjithsej 3 kryetarë. Degët e punëve të brendshme, me miratimin e sekretarit të parë të

komitetit të PPSH-së së rrethit, i paraqisnin komisionit qendror në

Disa vendime të komisionit të vitit 1954

Më 30.1.1954 komisioni merri vendimin për të konfiskuar pasurinë e të arratisurve Rexhep Turaku dhe Shaban Dagos. Po atë datë me një vendim tjetër, konfiskohej pasuria e Rexh Mehmetit pasi ishte arratisur nga Shqipëria.

Anastas Mihal Mari ndodhej i arratisur. Familja e tij kishte pasuri në zonë kufitare. Kjo pasur

ishte bllokuar. Për këtë arsye familja me 7 veta internohej në fshatrat e Lushnjës.

Vendimet e datës 19.2.1954

Me një vendim të posaçëm komisioni ka vendosur internimin e një sërë ish funksionarësh të "regjimeve të kaluara" të cilët kishin qenë me një postes të rëndësishme si shef shërbimi sekret, ministër, prefekt, kryetar njësie vendore, etj. Një pjesë e tyre ishin burgosur më parë dhe po provonin. Vendi i internimit ishte zgjedhur kryesisht në Rrethin e Fierit në fshatra të vështirë për jetesën.

Vendimet e 30.3.1954

Komisioni merri vendim më 30.3.1954 për internimin e Zef Shirokës nga Shkodra në fermën e Lushnjës për 5 vjet pasi i përmenduri kishte qenë pronar i fabrikës së çimentos në Shkodër, ministër i Industrisë e Tregtisë si dhe kryetar i Bashkisë së Shkodrës. Në këtë kohë komisioni përbëhej nga gjeneral – lejtant Mehmet Shehu (kryetar), gjeneral – major Kadri Hazbiu (nënkryetar) dhe anëtarët

gjeneral – major Delo Balili, nënkolonel Nevzat Hasnedari, nënkolonel Rexhep Kolli, nënkolonel Jashar Kasimati. Këta ishin funksionarë të Drejtorisë së Sigurimit të Shtetit në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Viktor Shantoja internohej nga Shkodra në Lushnjë pasi në kohën e Zogut kishte qenë qarkkomandant xhandarmërie.

Rusem Ymeri internohej nga Durrësi në një vend tjetër (shënohet dy herë vendi deri sa shkruhet në Rrethin e Fierit) si "mik i ngushtë i Abdurrahman Krosit", "simpatizant i Legalitetit" dhe se kishte qenë kryetar bashkie në atë kohë.

Izedin Beshiri, për shumë kohë sekretar i përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, deputet, etj, internohej në Rrethin e Fierit sepse "kishte urreyer LANÇ-in".

Nexhipe Osman Turaku me baba të pushkatuar, vetë e dënuar me 8 vjet burg si "agjente amerikane", dëbohej përgjithmonë nga tiranë për në Lushnjë.


Shumica e internimeve të kësaj kohe përcaktohen se janë në kampin nr.2 Shtyllas.

Shtëpia Botuese "55"

Botimet e reja

DONALD RUMSFELD

Të njohura dhe Të panjohura



Një rrëfim për jetën e një prej personazheve të jashtëzakonshëm të politikës...

“ Unë, kam rreth njëzet mijë memo, të quajtura me humor si “flokë bore”, prej kohës kur isha ministër i mbrojtjes në administratën e presidentit George W. Bush, disa regjistrime të momenteve të marrjes së vendimeve dhe të tjera që janë për shembull një shkuarje tek berberi. Mijra dokumente të tjera qëndrojnë në arkivat sekrete në Bibliotekën e Kongresit, Departamentin e Shtetit dhe atë të Mbrojtjes..” . Donald Rumsfeld

Botimet e reja



CIA ka hedhur poshtë njoftimet e fundit të kanalit "FoxNews" dhe njoftime të tjera sipas të cilave oficerëve të saj u ishte dhënë urdhër për "të mos vepruar" kur ata kishin kërkuar që të niseshin nga baza më e afërt për të zbrapsur sulmin ndaj konsullatës

CIA sqaron rolin e saj gjatë operacionin për të shpëtuar personelin diplomatik në Libi

Zyrtarët e shërbimeve sekrete kanë publikuar një pasqyrë të hollësishme të CIA-s për ngjarjet që shoqëruan sulmin vdekjeprurës të 11 shtatorit ndaj konsullatës amerikane në Bengazi të Libisë, si përgjigje ndaj akuzave se nuk ishte bërë mjaftueshëm për të ndaluar sulmin. Zyrtarë të lartë të shërbimeve të zbulimit, që folën pa u identifikuar u thanë

gazetarëve se CIA ndërmoi një mision shpëtimi nga baza më e afërt brenda 25 minutave që u sinjalizua për sulmin, ku u vranë ambasadori amerikan në Libi dhe tre amerikanë të tjerë. Por ata thanë se skuadra me 6 pjesëtarë mundi të arrinte mbas 25 minutash, pjesërisht sepse dështoi përpjekja për të patur mbështetjen e ushtrisë

së Libisë me armatime të rënda, e gjithashtu sepse ata ishin nën breshërinë e armëve të zjarrit teksa i afroreshin konsullatës. Skuadra e CIA-s njoftoi se qëndroi në konsullatë për një orë e më pas u largua prej saj duke nxjerrë prej andej gjithë personelin amerikan të konsullatës, përveç ambasadorit të vranë, i cili ishte çuar në spitalin më të afërt. CIA

ka hedhur poshtë njoftimet e fundit të kanalit "FoxNews" dhe njoftime të tjera sipas të cilave oficerëve të saj u ishte dhënë urdhër për "të mos vepruar" kur ata kishin kërkuar që të niseshin nga baza më e afërt për të zbrapsur sulmin ndaj konsullatës.

Obama dhe Romni thellojnë forcat në shtetet e pasigurta dhe vendimtare për fitoren presidenciale

Vetëm pak ditë para zgjedhjeve të 6 nëntorit, presidenti i Shteteve të Bashkuara, Barack Obama, dhe sfiduesi i tij republikan, Mitt Romney, pritet të përqendrojnë forcat në ato shtete ku sondazhet e opinionit kanë sugjeruar se asnjëri kandidat nuk ka siguruar diferencën definitive të fitores. Këto shtete përfshijnë Ohajon, Koloradon, Ajouan, Floridën, Nju Hempshirin, Uiskonsinin, Virxhinian dhe Nevadan. Fituesi i presidencialeve në Shtetet e Bashkuara nuk është kandidati që siguron numrin më të madh të votave popullore në gjithë vendin, por ai që kap të paktën 270 vota të Kolegjit Zgjedhor. Çdo shtet ka një pjesë të votave zgjedhore, bazuar në madhësinë e tij.

Sondazhet e fundit mbarëkombëtare vazhdojnë të flasin për garë të ngushtë. Pas disa ditësh pauzë, për shkak të stuhisë Sandy, e cila ka goditur bregun lindor të SHBA-së, Obama ka bërë fushatë në Uiskonsin dhe Nevada, ndërsa Romney në Virxhinia.

Romney, kësaj here, ka akuzuar presidentin Obama se bën përpjekje të zgjerojë agjencitë federale. Ai dhe Partia e tij Republikane kanë thënë se janë kundër qeverisë më të madhe, duke argumentuar se zgjerimi mund të pengojë rritjen ekonomike. Pas disa vjetësh rritje të ngadaltë, Romney ka thënë se Amerika ka nevojë për "ndryshim të vërtetë", të cilin mund ta bëjë ai. "Unë e di se ka disa njerëz që besojnë se duhet të mbetemi në drejtimin aktual dhe që mendojnë se gjërat janë në rregull. Unë nuk mendoj se status quo-ja është e mirë për Amerikën. Unë mendoj se Amerika përfundimisht ka nevojë për ndryshime të vërteta", ka thënë Romney. Obama, duke folur në Uiskonsin, ka adresuar po ashtu temën e ndryshimit, duke u kthyer te një motiv, i cili ka qenë kyç për fushatën e tij të suksesshme në zgjedhjet e vitit 2008. Obama ka thënë se Romney, biznesmen dhe ish-guvernatori i Masacusetit, në vend që të mbështesë ndryshimet e vërteta, ai thjesht mbështet politikën e njëjta të ish-presidentit George Bush.

"Tani, në javët e fundit të kësaj fushate, guvernatori Romney ka përdorur gjithë talentin e tij si shitës për politikën që kanë çuar vendin tonë në dështim - politikën që kemi bërë përpjekje të pastrojmë gjatë katër vjetëve të fundit. Ai i ofron ato si ndryshime", ka thënë Obama. Në një zhvillim tjetër, majori i Nju Jorkut, Michael Bloomberg, ka theksuar mbështetjen e tij për Obamën. Bloomberg ka përmendur nevojën për udhëheqjen e ndryshimit klimatike, duke thënë se Obama ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm për të reduktuar konsumin e karbonit, të cilin shkencëtarët e fajësojnë për ndryshimet klimatike. Tendencë SHBA, shkon në 74 numri i viktimave nga uragani Sandy. Në Nju Jork metroja dhe autobusët rifilluan shërbime të kufizuara pas ndalimit të tyre për katër ditë për shkak të uraganit

Këto shtete përfshijnë Ohajon, Koloradon, Ajouan, Floridën, Nju Hempshirin, Uiskonsinin, Virxhinian dhe Nevadan. Fituesi i presidencialeve në Shtetet e Bashkuara nuk është kandidati që siguron numrin më të madh të votave popullore në gjithë vendin, por ai që kap të paktën 270 vota të Kolegjit Zgjedhor



Sandy. Punonjësit e emergjencës po pompojnë ujin nga tunelet dhe ndërtesat e përmytura ndërkohë që qyteti dhe periferitë e tij po përpriqen të mëkëmben pas stuhisë. Për të shmangur bllokimin e trafikut, makinat me më pak se tre njerëz nuk lejohet të hynë në qytet. Shkollat janë të mbyllur dhe qindra mijëra njerëz janë ende pa drita, një vështirësi e madhe kjo në një qytet ku shumë njerëz jetojnë nëpër gradaçela. Autoritetet e Nju Jorkut po paralajmërojnë njerëzit që të mos notojnë apo të vozitin në lumenjtë dhe gjiret e qytetit për të shmangur ndotjet. Më shumë se një milion njerëz në Nju Xhersi, të cilët u goditën nga stuhia, janë pa energji elektrike. Rradhët e makinave zgjaten rreth dy kilometra në ato pak stacione benzine që funksionojnë. Numri i përgjithshëm i të vdekurve në Nju Jork dhe Nju Xhersi qendron në 59. Ekipet e shpëtimit thonë se presin të gjejnë trupa të tjerë ndërkohë që vazhdojnë kërkimet në rrënojat e shtëpive. Numri total i të vdekurve nga stuhia Senti është të paktën 74 në Shtetet e Bashkuara dhe 65 në Bahamas, Kubë, Haiti dhe Xhamajka. Dëmet në Shtetet e Bashkuara llogariten në rreth 50 miliardë dollarë. Ndërsa qeveria qendrore dhe ajo

lokale po i përgjigjet fatkeqësisë së uraganit Sandy që goditi brigjet lindore në SHBA, mbeten të vlefshme mësimet që u nxorën nga gabimet gjatë përpjekjeve për rimëkëmbjen nga uragani Katrina të vitit 2005. Siç njofton korrespondenti i Zërit të Amerikës Greg Flakus nga Hjustoni, agjencitë qeveritare dhe operacionet private të shpëtimit, megjithatë janë duke u përballur me sfida të jashtëzakonshme. Fatkeqësia më e madhe natyrore në historinë e Shteteve të Bashkuara ishte uragani Katrina, që shkaktoi më tepër se 1 mijë e 800 të vranë, la mbi 1 milionë njerëz pa shtëpi dhe rreth 3 milionë të tjerë pa energji elektrike në rajonin e Gjirit të Pjesamë e madhe e New Orleansit të Luzianës u përmyt, kur barrierat u shkatërruan dhe disa pjesë të qytetit ende nuk janë rimëkëmbur plotësisht. Në Universitetin Tulane të New Orleansit, Marc Roy punon për një nga programet e masterit për menaxhimin e fatkeqësive natyrore. Ish-specialisti i ndihmave dhe rimëkëmbjes në Agjencinë Federale të Menaxhimit të Emergjencave, FEMA, thotë se shkatërrimet që ndodhën nga uragani Sandy mund të ishin edhe më keq, për shkak të numrit tepër të madh të popullsisë

që prekën. "Nga Sandy mund të jenë prekur rreth 60 milionë banorë, pra kur flitet për ndikimin gjeografik, ai do të jetë tepër i madh dhe do të jetë një provë për agjencitë e ndihmave". Zoti Roy thotë se mbyllja për një kohë të gjatë e autostradave dhe metrove në New York dhe qytete të tjera, mund të pengojë hapjen e bizneseve dhe mund të mos i lejojë njerëzit të kthehen në punë. Në se vazhdojnë të mbeten pa energji elektrike miliona njerëz për një kohë të gjatë, ata do të dëshpërohen. "Mungesa e dritave për një periudhë të gjatë pas fatkeqësive natyrore sjell shumë problem, ka jo vetëm pasoja ekonomike, por edhe psikologjike, ngaqë ndikon tek jeta e përditshme e njerëzve". Por Roy thotë se agjencitë qeveritare, FEMA në veçanti, kanë nxjerrë mësim nga gabimet që u bënë në javët që pasuan uraganin Katrina. Ai thotë se komunikimi dhe koordinimi mes zyrave qeveritare të niveleve të ndryshme tani është shumë më i mirë se sa ishte 7 vjet më parë. Ai thotë se qeveria po ashtu nxori mësim nga organizatat private të ndihmave, si Kryqi i Kuq Amerikan dhe në veçanti, kompania gjigande e shitjeve me pakicë, Wal Marti, që çuan furnizime uji dhe ushqimesh

tek disa nga zonat e prekura nga uragani Katrina më shpejt se agjencitë qeveritare. Walmart mbylli 290 dyqane në 10 shtete të prekura nga uragani Sandy këtë javë, por të martën në mbremje, shumica e tyre, rreth 220, u rihapën, me funksionim të plotë, thotë zëdhënësi i kompanisë, Kayla Whaling. "Ne kemi një rrjet emergjence të shpërndarjes, që na mundëson dërgimin e disa mallrave të nevojshëm në zonat e stuhisë". Ajo thotë se i njëjti sistem logjistik që ndodhet në zyrat e kompanisë në Bentonville të Arkansasit i ndihmon kompanitë të operojnë qendrat e emergjencës, duke u shpërndarë ushqime, ujë dhe materiale të tjera komuniteteve në nevojë. "Ne jemi partnerë me Kryqin e Kuq, komunikojmë me organizatat lokale, në mënyrë që të dimë se çfarë artikujsh nevojiten, për t'u siguruar që të furnizohen njerëzit me mallrat e nevojshme". Zonja Whaling thotë se kompania Walmart po ashtu mbetet në kontakt të vazhdueshëm me autoritetet lokale dhe federale në zonat e prekura nga fatkeqësitë, në mënyrë që të ketë koordinim mes tyre dhe që milionat klientëve të u çohen pa humbur kohë artikujt më të nevojshëm.

Siri:
Opozita pretendon sukses në luftimet në veri



Aktivistët thonë se opozita në Siri ka marrë kontrollin e një qyteti strategjik në veri të vendit, i cili shihet si një pikë kyçe për fushatën e egër që qeveria ka ndërmarrë kundër rebelëve në qytetin e Alepos. Vëzhguesi Sirian për të Drejtat e Njeriut thotë se forcat besnike të presidentit Bashar Al Assad janë tërhequr krejtësisht nga qyteti Surahukib, ku kalojnë rrugët kryesore kombëtare që lidhin Alepon me Damaskun dhe që të çojnë në bregdetin e Mesdheut. Aktivistët thonë se të paktën 28 ushtarë u vranë gjatë sulmeve gjatë luftimeve të djeshme. Mas sulmeve në internet nisi të qarkullojë një video ku tregohen rebelët sirianë që po ekzekutojnë disa ushtarë. Mendohet se ushtarët u vranë pasi janë dorëzuar. Kombet e Bashkuara thonë se kjo video ka të ngjarë që të jetë provë për krime kundër njerëzimit. Grupet e të drejtave të njeriut mes tyre Amnesty International i kanë dënuar sulmet e dyshuara.

Shtëpia Botuese "55"

Botimet e reja

SIGURIMI I SHTETIT 1944 - 1991

Kastriot DERVISHI



SIGURIMI I SHTETIT 1944 - 1991

Historia e policisë politike
të regjimit komunist



55
Shtëpia
Botuese

Libri: "Sigurimi i Shtetit 1944 - 1991. Historia e policisë politike të regjimit komunist", 250 faqe
Autori: Kastriot Dervishi
Shtëpia Botuese "55", Tiranë

Libri "Sigurimi i Shtetit 1944 - 1991. Historia e policisë politike të regjimit komunist" është studimi i parë i plotë në lidhje me aktivitetin e një prej strukturave më të mprehta të diktaturës komuniste në Shqipëri. Mekanizmi i ndërtimit të Sigurimit të Shtetit, platformat e tij, funksionimi nga qendra në bazë, etj, marrin përgjigje menjëherë në studim. Platformat e mbi të cilat bazohej puna e organeve të punëve të brendshme, veçmas e Sigurimit, çelësi i gjithë veprimeve të këqija, njihen tashmë në mënyrë më të plotë e më të qartë. Roli i jugosllavëve në strukturimin e parë të Sigurimit apo emërtimin e tij dhe ai i sovjetikëve në formatimin agresiv e agjenturor të kësaj arme analizohen në kapituj të veçantë të librit.

Për herë të parë dalin në pah statistika mbi rrjetin agjenturor të Sigurimit, përpunimet (përndjekjet), sipas niveleve të tij, rolit, vërtetësisë dhe peshës që ka pasur). Shpjegohen mënyra e arrestimeve, internimeve, veprat politike më të përndjekura, kontingjentet, etj. Kjo sepse degët e Sigurimit ishin struktura të specializuara të kryenin këtë procedurë.

Libri hedh dritë mbi rolin e vërtetë të Sigurimit, pa zmadhimet e pa figurën e mitit dhe përfytyrimit, por mbi bazën e fakteve dhe analizës historike.

Libri është i strukturuar në 15 kapituj. Ai merret kohën e vërtetë kur është krijuar arma e specializuar e diktaturës, drejtimin e saj me Partinë e Punës të Shqipërisë, roli i Enver Hoxhës në të, drejtimet kryesore kundër elementit antikomunist, etj.

Shpjegohen mirë koha kur u krijua Drejtoria e Mbrojtjes së Popullit dhe Seksionet e Mbrojtjes së Popullit, në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes Kombëtare në vitet 1944 - 1946. Po ashtu formimi i Drejtorisë së Sigurimit të Shtetit brenda Ministrisë së Punëve të Brendshme si dhe ndarja në tri koka e kësaj strukture në vitet në pasojnë.

Nga studimi njihet e plotë gjithë struktura organizative të Sigurimit të Shtetit, degë për degë dhe funksion për funksion. Me këtë botim, Shqipëria plotësohet me statistika mbi shërbimet sekrete në ish lindjen komuniste.

Botimet e reja



KUVENDI NDERON 22 GRA TË SHQUARA

Kuvendi i Shqipërisë nderoi dje kontributin dhe dinjitetin e grave të shquara shqiptare, në 100 Vjetorin e Pavarësisë.

Kuvendi i Shqipërisë, në një ceremoni të veçantë në sallën e veshur kuq e zi, nderoi dje kontributin e grave shqiptare në 100 vjet Pavarësi të cilat, i dhanë nder dhe krenari kombit shqiptar. Sot ne nderojmë brishtësinë, delikatesën, dinjitetin e gruas shqiptare, kësaj gruaje të lindur në "djepin e tragjedisë" e të "dramës pa fund", por që kurrë nuk u vyshk në freskinë e në fisnikërinë e saj njerëzore. Sot, nderojmë një pjesë të grave simbol të qëndresës e të forcës së gruas shqiptare, siç vetëm një grua shqiptare mund të jete." tha Kryetarja e Kuvendit. Zonja Jozefina Topalli, me motivacione të veçanta në shenjë mirënjohje dhe falënderimi për misionin e tyre, dhuroi botimin special të Kuvendit "Akteve të themelimit të shtetit shqiptar", duke nderuar një pjesë të grave simbol të qëndresës dhe të forcës së gruas shqiptare siç vetëm një grua shqiptare mund të jetë.



traditën dhe shkollën shqiptare të një interpretimi besnik të këngës popullore.

ne skenë dhe kinema, shumë prej të cilave të paharrueshme e ende sot të freskëta.

dhe nënës labe, duke u shndërruar krenarisht në "laben" e kinematografisë shqiptare.

e Galerisë Kombëtare të Arteve në Tiranë.

Roza Anagnosti

Aktore e teatrit dhe kinematografisë, e cila me elegancën, finesën, feminilitetin dhe artin e saj me shumë se kushdo tjetër i dha figurës së gruas shqiptare forcën e delikatesën njëkohësisht.

Prof. Rushen Golemi

Ndër mjeket dhe kirurget e para shqiptare, autore tekste dhe artikujsh shkencorë, pedagogje e fakultetit të mjekësisë për disa dekada. Ndër të paktat deputete të parlamentit shqiptar në zgjedhjet e para pas rënies së komunizmit në vitin '91.

Suzana Turku

Figure e shquar e muzikologjisë sonë, dirigjentja e pare shqiptare e cila me korin "Pax Dei" sjell me mjeshtëri tingujt e paqes e të artit shqiptar e botëror në skenat tona.

Prof. Adelina Mazreku

E para kirurge onkologë shqiptare, me një kontribut të pazëvendësueshem në sensibilizimin, parandalimin dhe mjekimin e tumoreve, si hartuese e programit kombëtar të luftës kundër kancerit.

Cezarina Daragjati

Ndër të parat piktoresh shqiptare, me një aktivitet të çmuar artistik në vaj, kryesisht në gjininë e peizazhit, portretit e natyrës së qete.

Kristina Koljaka

Një nder gratë me të shkolluara në një Shqipëri ende me shumicë analfabete, skulptorja e parë shqiptare, e vlerësuar me çmim që në vitin '42 për punimet e saj nga Akademia e Arteve në Romë. Pedagogje pioniere e skulpturës në Institutin e Lartë të Arteve. 7 prej veprave më të mira të saj, pasurojnë sot fondin

Rajmonda Bulku

Eshte aktore, politikane, portret i hijshem i ekranit tone si pak te tjera,

por sot nuk e vlerojme per kete.

Sot e vleresojme per nje moment te jetes se saj, dhe tones pashmangshmerit,

ne te cilen u be "ZERI" i te gjithave ne, i grave shqiptare, nenave dhe motrave, me thirrjen e saj njerëzore ne 20 shkurt te '91, per te ulur armet e per te ndalur vellavrasjen per "idhuj te rreme"!!!

Thirrja e saj, ne emer te te gjithave ne, pavaresisht se ku ndodheshim fizikisht ne ate moment.... na cliroi! Hapi tjetër epoke!

Faleminderit Rajmonda Bulku!

Geraldine Appony, Mbreteresha e Shqiptareve,

Ne emer te te gjithë grave te huaja, qe per hir te dashurise lane vendin e tyre dhe lidhen fatin me kete vend te mrekullueshem por te shumevuajtur, e qe megjithese prej tij moren vetem vuajtje e padrejtësi, i dhuruan pafundesisht dashuri, linden dhe rriten femije patriotë te cilet i mekuan vetem me atdashedashuri.

Vace Zela

"Zeri", "tingulli" me i bukur i kenges, i melodise shqipe, e cila talentit qe bujarisht i fali Zoti, i shtoi pa kuresim, pasionin, shpirtin e saj, ne cdo korde, ne cdo note. "Zeri" qe hynte ne cdo shtepi, e ngrohte cdo zemer, me dashuri per "dashurine", me dashuri per jeten, me dashuri per atdheun.....ne nje kohe te veshtire, kur atdheu kishte fare pak....

ose aspak per t'l ofruar..... asaj.....e secilit prej nesh!!!

Te paperseritshmes Vace Zela, me mirenjohje!!!

Tefta Tashko Koço

E para artiste lirike, e një Shqipërie qe po përpiquej te dilte nga prapambetja dhe par-agjykimet mesjetare. Me zërin e saj hyjnor, dëshirën dhe vullnetin qe ky vend te rigjeje vokacionin e tij evropian, u be pionierja e pare e promovimit te vlerave te muzikës shqiptare, e shpirtit artist te kombit tone.

Lola Gjoka

E para pianiste shqiptare, e lindur, rritur dhe shkolluar ne mërgim, por që zgjodhi të kthehej ne atdhe ku ngriti nga asgjëja atë qe me vonë do të bëhej shkolla e pianos, duke qenë edhe e para pianiste koncertiste në Shqipëri me një karrierë 50 vjeçare të pandërprerë.

Marije Kraja

Soprano lirike, pioniere e muzikës dhe arsimit muzikor në Shqipëri, e cila si pedagogje që në fillim te viteve '30, formoi

Dr. Sabiha Kasimati

E para biologe, shkencëtare ne Shqipëri, me një aktivitet të dendur botimesh shkencore, ndër arsimtaret e para të "Institutit Femnor "Nana Mretneshe", Pushkatuar pa gjyq së bashku me 21 intelektuale të tjerë ne vitin 1951.

Musine Kokalari

Ndër të parat prozatore, publicistë, studiuese e psikologjise dhe zakoneve popullore, dhe sigurisht e para grua politikane ne Shqipëri, me një kontribut te shquar si profesoreshe ne Institutin Femnor "Nana Mretneshe". Burgosur dhe internuar deri ne fund të jetës se saj nga regjimi komunist.

Drita Pelinku

E para studente e artit dramatik ne Shqipëri, regjisore, pedagogje e profesioniste e aktrimit, e cila numëron 110 role

Tinka Kurti

Aktore e teatrit dhe kinematografisë e cila giate karrierës se saj, me mjeshtëri të rrallë ka interpretuar rolin e vajzës, nënës e gruas shqiptare, ne tiparet e tyre kryesore: karakterin e fortë, njerëzor e tragjik ne të njëjtën kohe. Teatri shqiptar ne Malmo te Suedise mban emrin e saj.

Margarita Xhepa

Aktore profesioniste, e cila me mjeshtërinë e aktrimit dhe sensibilitetin qe percon, pandërprere prej me shume se 60 vjetësh ne skenën shqiptare, është një nder gratë me të cilat kinemaja shqiptare identifikohet.

Luiza Laska

Për kontributin e paçmuar e të pandërprerë ne interpretimin me mjeshtëri si askush tjetër, të karakterit e integritetit të gruas

► **Bumçi: Festimet e 28 Nëntorit, nga Vlora në Tiranë**

Prezantohet kalendari i aktiviteteve me rastin e 100-vjetorit të Pavarësisë

Festimet e datës 28 Nëntor do të çelen zyrtarisht në Vlorë, ku do të zhvillohen homazhe, do të ngrihet flamuri, për të vazhduar më pas me festimet në kryeqytet, deri në orët e vona të natës, deklaroi sot, ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Aldo Bumçi, duke shtuar, se sipas Protokollit të Shtetit, siç ka qënë çdo vit, të gjithë personalitetet, të ftuarit, do të jenë në Vlorë.

“Ka ngjarje të shumta, si përrurimi i përmendores kushtuar 100-vjetorit të Pavarësisë, koncerte festive, mbrëmje solemne akademike dhe aktivitete të tjera, që do të zhvillohen gjatë datës 28 Nëntor në Tiranë”, tha Bumçi. Ministri tha gjithashtu se përveç kremtimeve të datës 28 personalitetet më të larta do të shkojnë në Vlorë edhe në datën 27, ku do të ketë koncert, darkë të shtruar, etj.

Gjatë një konference sot për mediat, Bumçi përmendi vetëm disa nga aktivitetet më të rëndësishme të kalendarit të aktiviteteve të 100-vjetorit, që pritet të bëhet publik në faqen zyrtare sëbashku me një preventiv për çdo aktivitet, ndërkohë që sipas ministrit, deri tani janë shpenzuar 300 milionë lekë.

Ministri i TKRS-së veçoi ardhjen në Shqipëri të armëve të Skënderbeut, “Mesharit” të Gjon Buzikut, përrurimin e monumenteve të Ismail Qemalit, Ahmet Zogut, Hasan Prishtinës, Festivalin e Filmit Shqiptar dhe Festivalin e Dramës Shqipe, etj.

“Do të çelet një ekspozitë me Kodikët e Beratit, ekspozitë fotografike e Marubit, do të zhvillohen konferenca shkencore, ku më e rëndësishmja është ajo e Qendrës së Studimeve Albanologjike, ku për 2 ditë do të mblihdhen 100 studiues për të diskutuar mbi çështje të ndryshme të historisë së vendit”, tha Aldo Bumçi.

Pjesë e aktiviteteve për 100-vjetorin është edhe një konferencë shkencore në lidhje me vendin se ku është botuar “Meshari” i Gjon Buzikut, si dhe një ekspozitë për bashkëkohësit e tij, Budi, Bogdani, Bardhi, etj. Do të përurohen gjithashtu edhe monumenti i Kongresit të Lushnjës, për Pjetër Arbërorin e Petro Markon.

Sipas ministrit Bumçi, së shpejti pritet të përfundojë edhe konkursi për siglën muzikore që do të shoqërojë festimet, i shpallur kohë më parë. “Festimet e 100-vjetorit përfundojnë në fund të muajit dhjetor. Në 3 dhjetor festohet 100-vjetori i themelimit të Ushtrisë, një nga vendimet

e para të qeverisë së Vlorës”, tha Bumçi.

Sipas tij, po kryhen procedura për të mbështetur vendosjen e bustit të Skënderbeut në Londër dhe në Budapest. Aktivitetet do të vazhdojnë edhe jashtë vendit, ku mbas tre javësh do të çelet në Romë një ekspozitë për trashëgiminë kulturore shqiptare, do të ketë një koncert në Bruksel.

KALENDARI I AKTIVITETEVE FESTIVE PËR 100-VJETORIN E PAVARËSISË

Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve publikoi kalendarin e aktiviteteve festive të 100-vjetorit të Pavarësisë, që në fillim të këtij muaji deri në fund të muajit dhjetor. Aktivitetet u çelën dje me vizitën e Sekretares Amerikane të Shtetit, Hillary Clinton dhe vazhduan sot me çeljen e ekspozitës “Koha e memorandumëve” në Bibliotekën Kombëtare Shqiptare.

► 03 Nëntor

17:30 Kinema Millenium, Tiranë - Festivali Mbarëkombëtar i Filmit, i cili do të hapet me premierën e kopjes së restauruar të filmit artistik “Nëntori i Dytë”.

► 04 Nëntor

11:30 Kinema Millenium, Tiranë - Premierë e filmit dokumentar “100 Vjet me Hymnin e Flamurit”

► 05 Nëntor

18:00 Muzeu Historik Kombëtar - Ekspozita “Veprimtaria e kolonive shqiptare të mërgimit në Rumani, Bullgari dhe Egjipt për çështjen kombëtare”

► 06 Nëntor

19:00 Teatri Kombëtar i Operas dhe Baletit - Mbrëmje artistike “Rituali i Muzave” kushtuar grave artiste

► 07 Nëntor

18:00 Muzeu Historik Kombëtar - Ekspozitë etnografike me veshje tradicionale nga trevat shqiptare (7-28 nëntor)

► 08 Nëntor

10:00 Biblioteka Kombëtare - Konferencë shkencore “Koleksionet albanologjike në shërbim të Historisë së Shqipërisë” organizuar nga Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë dhe Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës (8-9 nëntor)

► 09 Nëntor

09:00 Konferencë e nivelit të lartë e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës me temë “Diversiteti në Europë-një forcë për të ardhmen”

19:00 Kinema Millenium - Festivali Mbarëkombëtar i Filmit, Mbrëmja Gala ndarja e



çmimeve

► 10 Nëntor

19:00 Teatri Kombëtar - Hapja e Festivalit Mbarëkombëtar të Dramës Shqipe me pjesëmarrjen e 17 trupave teatrore nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia (10-21 Nëntor)

20:00 Teatri Kombëtar - Premiera e dramës “Ëndrra e Ismail Qemalit”, kushtuar 100-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë”

► 11 Nëntor 2012

11:00 Kodrat e Liqenit - Homazhe në memorialin e ushtarëve britanikë të rënë në Shqipëri gjatë Luftës së Dytë Botërore

► 12 Nëntor

11:00 Universiteti i Arteve - Konferencë shkencore me rastin e 40 vjetorit të themelimit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, me pjesëmarrjen e mbi 24 përfaqësuesve nga akademitë e shkencave në mbarë botën

12:00 Biblioteka Kombëtare - Ekspozita e Mesharit të Gjon Buzikut (12-28 nëntor)

12:00 Prishtinë - Ekspozita “Koha e memorandumëve” (12-28 nëntor)

► 13 Nëntor

18:00 Muzeu Kombëtar - Përrurimi i ekspozitës «100 Vjet Pavarësi» me koleksione dhe eksponate të rralla nga bukinistët dhe koleksionistët shqiptarë. Turi i kësaj ekspozite do të hapë siparin në Tiranë, më datat 13-17 nëntor dhe do të vijojë në Prishtinë më 18-21 nëntor, Prizren 22 nëntor dhe Vlorë 24-28 nëntor

► 14 Nëntor

11:00 Pallati i Kongreseve - Çelja e edicionit XV «Panairi Kombëtar i Librit Tirana 2012». (14-18 Nëntor)

► 15 Nëntor

11:00 Biblioteka e Vjetër, Salla “Lumo Skëndo” - Cer-

emonia e dhënies së “Çmimit Kombëtar të Bibliofilisë “Lumo Skëndo”

► 16 Nëntor

18:00 Muzeu Kombëtar - Ekspozitë fotografike “Historia e Shqipërisë nëpërmjet Marubëve” dhe përrurimi i librit “Marubi” (16-28 Nëntor)

► 17 Nëntor

10.00 - 12.00 Pallati i Brigadave - Homazhe dhe ceremoni zyrtare me rastin e kthimit të eshtrave të Mbretit Zog në atdhe

16:00 Pallati i Kulturës - Ekspozita “Kolonitë arbëreshe dhe Pavarësia e Shqipërisë”

16:00 Pallati i Brigadave i hapur për qytetarët, nga data 17 deri më 25 Nëntor

► 18 Nëntor

11:00 Muzeu Historik Kombëtar - Ekspozita “Personalitete franceze për Shqipërinë dhe shqiptarët”

19:00 Teatri Kombëtar i Operas dhe Baletit - Vënia në skenë e Operas “Scanderbeg”. A Vivaldi. (në datat 18-19 dhe 20 nëntor)

► 19 Nëntor

12:00 Teatri Kombëtar i Operas dhe Baletit - Koncert me veprën fituese të Konkursit Mbarëkombëtar të Muzikës kushtuar 100 vjetorit lindjes së Nënë Terezës. Promovimi i albumit “Lutjet e Nënë Terezës”, V. Zhiti, R. Tasho

► 20 Nëntor

11:00 Ceremonia e përrurimit të shtatores kushtuar Azem Hajdarit

14:00 Kukës - Kupa “100-Vjet Pavarësi” në futboll (ndeshja e parë, Mitrovica-Prishtina)

► 21 Nëntor

11:00 Tiranë - Ceremonia e përrurimit të shtatores kushtuar Presidentit Willson

"Ka ngjarje të shumta, si përrurimi i përmendores kushtuar 100-vjetorit të Pavarësisë, koncerte festive, mbrëmje solemne akademike dhe aktivitete të tjera, që do të zhvillohen gjatë datës 28 Nëntor në Tiranë"

Maqedonisë Z. Musa Xhaferri, me pjesëmarrjen e Kryeministrit të Shqipërisë, Sali Berisha dhe Kryeministrit të Kosovës, Hashim Thaçi.

19:00 Kinema Millenium dhe Imperial - Shfaqja e një sërë filmash dokumentarë kushtuar personaliteteve dhe ngjarjeve të ndryshme historike

► 26 Nëntor

09:00 Hotel Tirana International - Konferencë shkencore "100 - Vjet Pavarësi e Shqipërisë" me pjesëmarrjen e rreth 100 studiuesve shqiptarë dhe të huaj

11:00 Bulevardi Dëshmorët e Kombit - Ceremonia e përrurimit të shtatores kushtuar Ismail Qemalit

Koncert artistik - Bashkia Tiranë, pedonalja

Ekspozitë artistike "100 - Vjet Tirana" - Bashkia Tiranë

► 27 Nëntor

10:00 Përrurimi i autostradës Morinë - Prishtinë

17:00 Finale e Kupës "100 vjet Pavarësi" në futboll Vlorë

18:30 - Koncert festiv në Vlorë me pjesëmarrje trupash artistike nga vendi. Marrin pjesë Presidenti i Republikës, Kryetarja e Kuvendit, Kryeministri i Shqipërisë, Trupi Diplomatik, Kryetari i Bashkisë Vlorë dhe personalitete të huaja

► 28 Nëntor

10:00 Vlorë - Hapja zyrtare e ceremonisë së kremtimit të 100 vjetorit të Pavarësisë, homazhe në Monumentin e Pavarësisë dhe vendosje kurorash mbi varrin e Ismail Qemalit

13:00 - Ceremonia e vendosjes së kurorave dhe nderimit pranë monumentit Nënë Shqipëri

14:00 - Koncert festiv në Sheshin Skënderbej

17:00 - Parada e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në "Sheshin Skënderbej" dhe mbajtja e fjalës së rastit nga Presidenti i Republikës

17:30 - Ceremonia e përrurimit të përmendores kushtuar « 100 - Vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë »

18:00 - Mbrëmje solemne akademike në Pallatin e Kongreseve

19:30 - Koncert i madh përmblyës në Sheshin "Nënë Tereza"

► 30 Nëntor

20:00 - Teatri Kombëtar i Operas dhe Baletit - Koncert me vepra të zgjedhura nga krijimtaria e kompozitorëve shqiptarë

► 04 Dhjetor

10:00 - Ekspozitë me rastin e 100-vjetorit të themelimit të Ushtrisë

18:00 - Koncert me rastin e 100-vjetorit të themelimit të Ushtrisë

► 07 Dhjetor

Festival Muzikor "Different Trains" në datat 7-9 dhe 10 dhjetor, organizuar në Akademinë e Arteve, Teatrin Kombëtar të Operas dhe Baletit

► 20 Dhjetor

Ceremonia e ndarjes së "Çmimeve Kombëtare të Letërsisë"



FIER: NIS PUNA PËR NDËRTIMIN E MEMORIALIT "EUROPA PLAZA"

Në qytetin e Fierit ka nisur sot puna për ndërtimin e memorialit "Europa Plaza", në kuadër të 100 vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë. Nën kryetari i bashkisë, Flamur Mato, tha se "ka filluar puna për ndërtimin e platformës së betontë, ku do të instalohet monumenti i titulluar "Europa Plaza". "Ky simbol që po ndërton bashkia, në bashkëpunim me kompaninë private "ALB-STAR", ka vlera shumëdimensionale. Ai është është një monument artistik

unikal, i konceptuar si një monument lavdie i qytetit të Fierit", theksoi Mato. Sipas tij, monumenti do të jetë një glob shumëngjyrësh alumini, me dimension sa një e treta e rrethrotullimit të sheshit "Fitorja", së bashku me 27 shtiza flamujsh të vendeve të BE-së. "Ne do ta përfundojmë këtë simbol të lavdisë dhe krenarisë historike para 28-Nëntorit dhe do t'i ftojme të gjithë ambasadorët e vendeve të Europës të vijnë të ngrejë flamurin në këtë memorial, që përcjell

ëndrrën e bukur për një të ardhme të përbashkët", tha Mato.

Skulptori shqiptaro-austriak, Fate Velaj, ideator dhe realizues i këtij projekti, u shpreh se "ky simbol reflekton, ruan dhe përcjell vlerat kombëtare, por njëkohësisht i pasuron ato me frymën e re të familjes europiane". Ai tha se "globi do të ketë ngjyrë blu dhe bojëqielli për të simbolizuar mëngjeset e pastra europiane, por edhe nuancat e së kuqes, kujtesë historike për luftërë dhe përgjakshme ballkanike"


GJIROKASTËR: NIS EKSPEDITA ARKEOLOGJIKE "ANTIGONE 2012"

Një ekip shqiptar arkeologësh kanë nisur këto ditë një fushatë të re gërmimesh arkeologjike në një zonë brenda Parkut Arkeologjik të Antigonesë, 14 km në lindje të qytetit të Gjirokastrës. Qyteti antik i Antigonesë, që daton në shek 3-2 para erës sonë, aktualisht është i vetmi sit arkeologjik në Shqipëri, ku që prej vitit 2010 kryhet një ekspeditë arkeologjike kërkimore-shkencore, e përbërë vetëm nga arkeologë shqiptarë.

Kjo ekspeditë financohet nga qeveria shqiptare nëpërmjet Institutit të Arkeologjisë pranë Qendrës së Studimeve Albanologjike në Tiranë.

Ekspedita "Antigone 2012", që drejtohet nga arkeologu shqiptar Prof. dr Dhimitër Çondi, është përqendruar në një zonë që është eksploruar për herë të parë një vit më parë, gjatë së cilës arkeologët arritën të zbulojnë një objekt unik të përdorimit të përditshëm familjar në lashtësi, një mekanizëm guri të punuar me mjeshtëri, që shërbente për të bluar drithërat.

Prof. dr. Dhimitër Çondi, shprehet se "gërmimet janë fokusuar në nxjerrjen në dritë të një pjese të mirë të urbanistikës së qytetit antik, me një numër të madh mjedisesh shërbimi dhe familjare banimi, si mjediset e një punishteje për përpunimin dhe



endjen e pëlhurave prej leshi dhe elementë të rëndësishëm arkitekturorë të një fasade të aksit kryesor rrugor të qytetit antik, një punishte enësh prej balte, etj".

Gjatë kësaj fushate gërmimesh, ekipi arkeologjik, duke respektuar strategjinë e gërmimeve të parashikuar në planin e menaxhimit afatmesëm të Antigonesë, do të vazhdojë punimet edhe në tri pika të këtij parku arkeologjik.

Volumi më i madh i gërmimeve të kësaj ekspedite do të kryhet në qendër të parkut, në vazhdim të aksit kryesor të rrugës që përshkon qytetin antik nga Porta Kryesore Jugore deri në Portën Veriore pranë Akropolit.

Në këtë zonë gërmimet e mëparshme kanë nxorren në dritë një pjesë të madhe

të murit kufizues të rrugës kryesore, një sipërfaqe e konsiderueshme e bllokut të banesave të qytetit dhe një inventar i pasur me gjetje arkeologjike si orendi të përdorimit të përditshëm familjar në qeramikë, mjete pune për teknologjinë e endjes së pëlhurës, një numër i madh mjedesh pune të përdorimit në bujqësi, monedha të Koinon-it të Epirit, maja metalike heshte, objekte zburkimi, pjesë amfore dhe pitosa, etj.

Drejtesit dhe ekspertët e Zyrës së Administrimit dhe Koordinimit të parkut Arkeologjik Antigone kanë marrë masa të gjithanshme për të krijuar kushte të favorshme pune për arkeologët e angazhuar në ekspeditën kërkimore shkencore "Antigonea 2012".

14:00 Shkodër- Kupa "100-Vjet Pavarësi" në futboll (ndeshja e dytë Tiranë-Otrant)

18:00 Teatri Kombëtar - Mbyllja e Festivalit Mbarëkombëtar të Dramës Shqipe me shfaqjen e Trupës Teatrorë të Prishtinës

► 22 Nëntor 2012

Mbërritja në Shqipëri e shpatës dhe përkrenares së Heroit Kombëtar Gjergj Kastriot Skënderbeu

14:00 Pogradec - Kupa "100-Vjet Pavarësi" në futboll (ndeshja e tretë Shkëndia Tetovë-Renovë)

► 23 Nëntor

10:00 Biblioteka Kombëtare - Konferencë e studiueses dhe albanologes Prof. Luçia Nadin me temë "Studime mbi Mesharin e Gjon Buzukut"

18:00 Festivali Ndërkombëtar i Filmit (TIFF)

► 24 Nëntor

10:00 Muzeu Historik Kombëtar - Konferencë e studiueses dhe albanologes Prof. Luçia Nadin, mbi zbulimet e saj në arkivat veneciane dhe motivet shqiptare të Kishës së Shën Sebastianit

12:00 Ceremonia e përrurimit të shtatores kushtuar Mbretit Zogul

18:00 Muzeu Historik Kombëtar - Ekspozita "Dorëshkrime Bizantine dhe Pاسبizantine në Shqipëri" - ekspozimi i 15 kodikëve origjinalë

► 25 Nëntor


11:00 Dhërmi- Ceremonia e përrurimit të bustit të Petro Markos

19:00 Shkup- Ceremoni e madhe festive organizuar nga Ambasada e RSH në Maqedoni dhe Këshilli Organizativ për Festimet e 100 vjetorit, nën kujdesin e ZV./Kryeministrit të

Shtëpia Botuese "55"

Botimet e reja

JERUZALEMI



Qyteti ka qenë shkatërruar, rindërtuar, rrënuar dhe ringrituar prapë. Jeruzalemi është një nimfomaniake e vjetër, që i shtrydh të dashurit e saj njëri pas tjetrit deri në marrjen e frymës së mbramë, para se t'i flakë tutje, me një gromësi-më, një vejushë e zezë, e cila i përllan meshkujt, ndërsa janë ende duke depërtua...r trupin e saj." Amos Oz, Një përrallë Dashurie dhe Terri". Ky liber i cili ka vetem 2 muaj që ka dale ne treg ne UK vijon te jete ne top listen e librave me te shitur ne Britanine e Madhe dhe me i komentuari ne media. Libri eshte perkthyer ne shqip nga Etleva Sakajeva

Botimet e reja